



“USHTIMA” E WIKILEAKS..!

Shqetësim, frikë dhe panik thuajse në të gjithë botën. Jo nga temperaturat e ulëta ekstreme që pritet të ndodhin këtë dimër dhe as nga ndonjë meteor i madh që pritet t'i mëshojë tokës dhe ta copëtojë atë. Por pikërisht nga Wikileaks, faqe interneti e themeluar nga një person kontrovers, që ditëve të fundit ka filluar të publikojë sekretet e të gjithë botës, së paku ai kështu pretendon dhe në atë mënyrë bota po reagon.

Po nxirren në shesh bisedat dhe planet e fshehta që janë bërë që nga Lindja e në Perëndim për t'u nisur një luftë, për t'u inskenuar një krizë, të përhapet një frikë nga ndonjë sëmundje ngjitëse, të trishtohet bota nga terroristët muslimanë, të rrëzohet një tiran, të krijohet një hero, të mëshirohet një viktimë, kush do të pasurohet, kush do të izolohet dhe çka jo tjetër!

Kjo ndodhi, siç vërehet shumë njerëz i gëzon sepse shumë gjëra të paqarta do të qartësohen, disa e shohin si lojën e radhës, me qëllim që ta largojnë vëmendjen e njerëzve nga problemet e përditshme, të cilave nuk po iu gjendet zgjidhja dot dhe të tjerë frikohen thellësisht, se ato fakte do të shkaktojnë shumë probleme, do të prishin ekuilibrin e shumtë dhe do të sjellin dështimin e politikave botërore, gjëra të cilat do të kenë pasoja të rënda për njerëzimin në përgjithësi.

Kjo ngjarje mua më bëri ta kujtoj Ringjalljen, ditën kur do të shpaloset gjithçka, kur nuk mund të fshihet askush dhe asgjë, ditën e Takimit: **“...kur të vijë Ushtima. Atë ditë njeriu do të ikë nga i vëllai, nga e ëma dhe nga i ati, nga e shoqja dhe nga fëmijët e vet. Atë Ditë, secili prej tyre do të ketë aq shqetësim për veten, sa do t'i mjaftojë”.** (Abese 33-37).

Secili do të shqetësohet për shkujdesjen ndaj fëmijëve, padrejtësinë ndaj bashkëshortes/it, keqbërjen ndaj prindërve, mospërkrahjen ndaj vëllezërve, urrejtjen ndaj dashamirëve, tradhtinë ndaj bashkëpunëtorëve dhe mosbërjen e asaj që duhet në përgjithësi.

Prandaj le të kemi frikë vetëm atë ditë, kur me të vërtetë gjithçka bëhet e qartë, do të kuptohet çka ishte realitet e çka teatër. Le të kemi frikë Allahun dhe të bëjmë atë që na porositi Ai, sepse aty është e gjithë mirësia edhe nëse njerëzve në fillim nuk u duket e mirë. Le të jemi larg përshkrimit që Allahu e bëri për dyfytirëshat: **“Ata fshihen nga njerëzit, por nuk fshihen dot nga Allahu. Ai është pranë tyre edhe natën, kur trillojnë gjëra me të cilat Ai nuk është i kënaqur. Allahu përfshin (me dijen e Tij) gjithçka që ata bëjnë”.** (Nisa 108).

Në emër të redaksisë: Omer BERISHA

AKTUALE

**3-6 | ÇIFUTËT DHE FUSHATAT E FRIKËSIMIT NGA ISLAMI
NË EVROPË!!!!...**

7-8 | BLIC LAJME

SFIDA

9-10 | NDËRTIMI I RRETHIT TË ARTË

AKIDE

11-14 | SPROVA E DYSHIMEVE

DRITARE

15-17 | ZEMËRIMI NGA KAPLIMI I FATKEQËSIVE

18-20 | SEKRETI I FSHEHUR

21-23 | Prezantim i librit: NË PASQYRËN E OKSIDENTIT

FIKH

24-27 | SI TË LLOGARITËSH ZEKATIN E PASURISË TËNDE?

EKONOMI

28-31 | OBJEKTIVAT E SHERIATIT NË EKONOMINË ISLAME

FAMILJA

32-36 | FAMILJA, NJË INSTITUCION I RREZIKUAR

37-40 | KUR HESHTJA NUK ËSHTË FLORI

41-44 | SPROVA E FEMRAVE

TEFSIR

45-47 | SPROVAT E DYNJASË DHE SHPËRBLIMI I ALLAHUT

HADITH

48-51 | QËLLOJA ÇAKUT

THESARE

52-54 | GËNJESHTRA SI SËMUNDJE PSIKIKE

AVANCIMI PERSONAL

55-57 | ELIMINIMI I DRUAJTIES (II)

FETVA DHE KONSULTIME

**58-60 | NUK E NDIEJ ËMBËLSINË E BESIMIT, Ç'MË
KËSHILLONI?**

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,

Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA dhe Rashit ZYLFIU

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: **albislam@albislam.com**

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: **albislam.abonues@gmail.com**

ALBISLAM DOOEL

xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denarë)

xhirollogaria: 0270100245547

Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro etj.)

Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T.: KOB5MK2X

IBAN: MK07300701002455425

numri tatimor: 4030008038784



ÇIFUTËT DHE FUSHATAT E FRIKËSIMIT NGA ISLAMI NË EVROPË!!!...

Realiteti i kësaj frike dhe trishtimi nga shoqatat dhe organizatat e posaçme për pakicat e imiguara muslimane fshihet në atë se qytetari perëndimor po i afrohet Islamit, pasi e kapluan dyshimet nga teatri i ngjarjeve të njëmbëdhjetë shtatorit dhe i pasojave të tij

SALAH SAJFI

Gazetat perëndimore hera-herës na tregojnë se çifutët e Evropës ndjejnë një lloj shqetësimi lidhur me rritjen e numrit të muslimanëve në kontinentin

evropian dhe rritjes së ndikimit të tyre, si dhe lidhur me qëndrimet e tyre politike kundër entitetit sionist dhe çifut në anën tjetër. Kjo bëri që ata të nisin fushata frikësuese nga Islami në botë, nëpërmjet studimeve, statistikave, raporteve dhe artikujve të posaçëm për dukurinë e

frikës nga Islami. Kjo lidhet me idenë sioniste (çifute ekstremiste), e cila historikisht dhe aktualisht po lufton gjithçka islame dhe synon përhapjen e kësaj armiqësie në shoqëri të ndryshme njerëzore jomuslimane. Ata zgjedhin metodat nga më të ndryshmet reklamuese dhe propagandistike, nëpërmjet të cilave tregtojnë idetë e tyre të ndyra lidhur me Islamin.

Pa dyshim që dukuria e islamofobisë me shumicën e formave të veta është një pjellë e qartë sioniste, që synon të pohojë se Islami paraqet një rrezik të vërtetë për planetin tokë, prandaj nuk i mbetet gjë tjetër njerëzimit përveçse të ballafaqohet dhe të ndalë zgjerimin e tij. Nuk është për t'u çuditur që shumica e raporteve, statistikave dhe e literaturës nëpërmjet të cilave mediet perëndimore tërheqin vëmendjen për rrezikun e gjelbër – Islamin, të jenë formulim i qarqeve sioniste çifute që i shërbejnë prapa perdes, sidomos përderisa qendrat më të njohura ideologjike dhe organizatat mediatike në Perëndim drejtohen nga intelektualë me rrënjë çifute, madje disa prej tyre financohen nga qarqe sioniste. Kështu që është e natyrshme, se ato do të përqendrohen në ballafaqimin me Islamin me forma nga më të ndryshmet, ushtarake, ekonomike, kulturore, mediatike etj.

Roli i Lobi Sionist

Ashtu si Lobi Sionist ka ndikim të madh në Evropë dhe shprehet qartë se prania islame në Perëndim nënkupton një kërcënim më të madh ndaj interesave të tyre, për të cilat u angazhuan me qindra vite, derisa e bënë Perëndimin mjet për ndikimin e tyre botëror dhe

“Baybs mendon se “tre faktorë çojnë drejt islamizimit të Evropës: Dogma islame, demografia e popullsisë dhe ndjenja historike”, duke shtuar edhe faktin se numri i të krishterëve në Evropë po zvogëlohet...”

armiqësimin e tij kundër muslimanëve; po ashtu ata mendojnë se rritja e pranisë islame në Perëndim paraqet një kërcënim serioz ndaj përfitimeve dhe ambicieve të tyre.

Mediet botërore na kanë mundësuar t'i shohim pamjet e protestave në Gjermani, ku sionistët u ankoruan te djathtistët ekstremistë të krishterë, i përzier flamujt e djathtë me ato të Izraelit dhe dhanë shenja që ftonin në ndalimin e ndërtimit të xhamive në Gjermani, si dhe përhapën parulla për frikësimin e evropianëve nga i ashtuquajturi rreziku islam. Rreziku nga i cili u frikësuan qarqet sioniste çifute dhe ato djathtiste ekstremiste krishtere qëndron te organizimet fetare islame, qofshin ato të xhamive apo ato të qendrave edukative islame.

Realiteti i kësaj frike dhe trishtimi nga shoqatat dhe organizatat e posaçme për pakicat e imigruara muslimane fshihet në atë se qytetari perëndimor po i afrohet Islamit, pasi e kapluan dyshimet nga teatri i ngjarjeve të njëmbëdhjetë shtatorit dhe i pasojave të tij, ku tashmë

u vërtetua se Perëndimi me në krye SHBA dhe me presionet nga ekstremistët e djathtë të krishterë dhe të lobit sionist shpikën shtegun e terrorizmit për të realizuar projektin e globalizimit, të cilin e kundërshtojnë vetë perëndimorët, sepse ai ndërtohet mbi idenë e gëlltitjes së qytetërimeve të tjera nga ana e qytetërimit perëndimor, gjë e cila kërcënon veçoritë e njerëzimit.

E djathta sioniste ekstremiste

Çështja e frikësimit nga rreziku Islam vjen paralelisht me kthimin e djathtistëve ekstremë sionistë në pushtet, pas luftës së Gazës, e cila i turpëroi sionistët përpara të gjithë botës dhe përpara Perëndimit në veçanti, gjë e cila bëri që të shtohen thirrjet gjithandej për të filluar hetimin e krimeve të sionistëve në Gaza. Kësaj i frikësohen sistemet perëndimore, të cilat pa ndonjë shkak tregtuan përrallën e holokaustit për t'i hedhur hi syve dhe për ta devijuar opinionin botëror nga krimet e çifutëve në Gaza.

Kohë pas kohe shfaqen raporte çifute që japin alarmin, se numri i çifutëve në Evropë po zvogëlohet e po ashtu edhe ndikimi i tyre politik në vendet ku jetojnë po zbrapset, e tëra kjo në një kohë kur forca e imigrantëve muslimanë po shtohet në ato vende. Alarmi më i fundit erdhi paralelisht me studimin që së fundmi ka përgatitur çifuti ekstremist amerikan Daniel Baybs, ku ai shfaq trishtimin që u përhihet çifutëve amerikanë nga rritja e numrit të muslimanëve në Evropë. Kjo çështje – supozojnë çifutët – paraqet një kërcënim serioz ndaj Shteteve të Bashkuara, po

“...Grupet çifute kanë filluar të dobësohen dhe të humbasin ndikimin politik, ndërsa forca e imigrantëve muslimanë po rritet...”

ashtu përgatit terrenin për t'i dhënë fund Evropës së krishterë dhe paralajmëron islamizimin e kontinentit plak, siç theksojnë ata.

Studimi në fjalë supozon se shtimi i numrit të muslimanëve në Evropë paraqet një problem të rëndë për ardhmërinë e kontinentit dhe ky shtim do të ketë pasoja të mëdha për njerëzimin, sidomos për Shtetet e Bashkuara, e cila lidhet me Evropën nëpërmjet shumë lidhjeve ekonomike të ndjeshme... aty thuhet: ardhmëria e kontinentit evropian është peng i tre skenarëve: “Qeverisja islame”, “Dëbimin e muslimanëve” dhe “Integrimi i harmonizuar”... ai shton: shumë prej analistëve besojnë se situata në Evropë do të përfundojë me islamizimin e saj pra, skenari i parë “Qeverisja islame” është më afër realizimit. Baybs mendon se “tre faktorë çojnë drejt islamizimit të Evropës: Dogma islame, demografia e popullsisë dhe ndjenja historike”, duke shtuar edhe faktin se numri i të krishterëve në Evropë po zvogëlohet.

Për sa i përket skenarit të dytë “Dëbimin e muslimanëve” studimi supozon se ai është opsioni më i përshtatshëm dhe shprehet: Shumë publicistë amerikanë besojnë se Evropa “është vendi më i mirë për gjenocid dhe

spastrim etnik”, ata gjithashtu mendojnë se muslimanët e Evropës do të ishin “me fat nëse dëbohen dhe shpëtojnë nga vrasja.”

Kurse për skenarin e tretë “Integrimi i harmonizuar” studimi thotë se imigrantët muslimanë me evropianët do të gjejnë “një metodë bashkëjetese” të harmonizuar, shanset për suksesin e këtij skenari janë të vogla.

Pakësimi i hebrenjve të Evropës

Raporti, i publikuar nga Instituti për Planifikimin e Politikës së Popullit Hebre në 2007, përmendë se numri i hebrenjve të Evropës po pakësohet çdo vit dhe se komunitetet evropiane çifute kanë filluar të zhduken për shkak të migrimit, bashkimit me komunitetet ku jetojnë dhe për shkak se ata përbëjnë një komunitet popullsie të moshuar, ndaj shumë grupe hebrenjsh në Evropë do të tkurren apo edhe do të zhduken plotësisht.

Një gazetë çifute përcjell nga një raport që udhëhiqet nga përgjegjësi amerikan me prejardhje çifute Denis Ros të ketë thënë: Grupet çifute kanë filluar të dobësohen dhe të humbasin ndikimin politik, ndërsa forca e imigrantëve muslimanë po rritet.

Mark Masuer në një shkrim të tijin rreth librit “Vështrime mbi revolucionin në Evropë... Migrimi, Islami dhe Perëndimi” të shkrimtarit Kristofer Kadol, thotë: Polemikë në këtë libër qartësojnë rënien e Evropës në shkapërderdhje kulturore, duke shtuar se migrimi i muslimanëve paraqet një pikë të rrezikshme ndryshimi. Autori në këtë libër gjithashtu shpjegon se evropianët kanë filluar të ikin jashtë nga frika e

Islamit. Autori mendon se shpejtësia dhe sasia e migrimit ka bërë të formohen qendra dhe organizime, ndërsa imigrantët përbëjnë pararojën e një force të madhe pushtuese për t'i rikthyer qytetet historike që u lëshuan nga banorët e saj të vërtetë. Migrimi i muslimanëve nuk është tjetër veçse një projekt për të zënë tokën dhe për të çuar Evropën në krahët e Islamit.

Dëbimi i muslimanëve

Përveç këtij shkrimi ka edhe qindra studime dhe shkrime të tjera, që i publikojnë çifutët në Perëndim, të cilët ankohen nga prania e muslimanëve dhe nga qytetërimi islam. Ata shfrytëzojnë disa situata sigurie në Perëndim për të argumentuar egërsinë e muslimanëve, që pastaj gjithsesi të fillojnë dëbimin e tyre nga Perëndimi, sepse na paraqitkan rrezikun për strukturën e sigurisë, atë politike madje edhe atë shoqërore dhe kulturore perëndimore. Fushatat e shumëllojshme kundër pranisë islame në Perëndim nuk kanë ndonjë dallim nga projekti i atij që ka aftësinë t'i largojë njerëzit nga shtëpia e vet. ■

Përshtati nga arabishtja: Omer B.

BANKË ISLAME BOTËRORE ME KAPITAL TË MADH NË VITIN 2011

Pritet që në vitin 2011 të fillojë nga puna një bankë islame botërore me kapital që do të arrijë në 3 miliardë dollarë. Këtë iniciativë e mori përsipër biznesmeni saudian dhe themeluesi i bankës “Beraka” Salih Kamil, i cili vite më parë ka planifikuar themelimin e një banke të madhe islame. “Ne që morëm përsipër themelimin e kësaj banke shpresuam ta bëjmë këtë në tremujshin e fundit të këtij viti, mirëpo nuk na premtoi koha, prandaj atë do ta bëjmë në vitin e ardhshëm. Hapat e ardhshëm do t’i konsultojmë gjatë Dhjetorit me Bankën Islame për Zhvillim, që ka selinë në Arabinë Saudite”, tha Kamil. Adnan Jusuf, kryetari ekzekutiv i bankës “Beraka” tha: Gjithsesi pritet që kapitali për bankën e re në fjalë do të arrijë në tre miliardë dollarë. /almoslim.net/ ■

ERDOAN PROPOZON KRIJIMIN E NJË SCHENGENI NË LINDJEN E MESME

Bejrut - Kryeministri turk, Rexhep Tajip Erdoan propozoi nga Libani krijimin e një zone për qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave në Lindjen e Mesme. “Arabët dhe turqit, edhe pse flasin gjuhë të ndryshme, kanë histori dhe kulturë të përbashkët”, deklaroi Erdoan gjatë fjalimit të hapjes së një forumi të Bankave të Bashkuara Arabe. “Kemi mundësi që shumë lehtë fqinjësinë tonë të mirë ta shndërrojmë në marrëdhënie vëllazërore, që së bashku të krijojmë një të ardhme më të mirë”, shtoi Erdoan, i cili nënshkroi me kryeministrin e Libanit, Saad el-Hariri, krijimin e një zone të tregtisë së lirë mes dy vendeve. Bankat e Bashkuara Arabe i dhanë kryeministrit turk, Rexhep Tajip Erdoan, çmimin “Lideri i Vitit 2010”./Start/ ■

WIKILEAKS, DOKUMENTE SEKRETE PËR VENDET E BALLKANIT

Faqja Wikileaks në Internet publikon të shumëpriturat mesazhe diplomatike mes Departamentit Amerikan të Shtetit dhe ambasadave apo përfaqësive amerikane nëpër botë. Janë afro 250 mijë dokumente diplomatike, korrespondenca mes DASH dhe përfaqësive diplomatike në vende të ndryshme të botës. Mes këtyre dokumenteve sekrete ka dhe dokumente ku flitet për Shqipërinë. Sipas të përditshmes gjermane Der Shpigel dokumentet sekrete për vendin tonë janë të ambasadës amerikane dhe datojnë nga viti 1997 deri më 2010. Gazeta Shqiptare bëri të ditur se emri i Shqipërisë përmendet në 822 file, apo dokumente sekrete. Ende nuk janë bërë të ditura, se çfarë përmbajnë këto materiale, por thuhet se pjesën

më të madhe të tyre e zënë marrëdhëniet kufitare me Shqipërinë dhe Greqinë. Dokumentet pritet të nxjerrin fakte të forta në lidhje me marrëdhëniet mes Tiranës dhe Athinës dhe për paktin uxor mes dy vendeve që u rrëzua pak muaj më parë nga Gjykata Kushtetuese në Tiranë.

Ndërkohë dosje sekrete ka edhe për Kosovën, e cila ka 1320 dokumente sekrete, Greqia 1758 dokumente sekrete, Maqedonia 783, ndërsa Turqia mban rekord në rajon dhe listohet e dyta në botë për sasinë e dokumenteve sekrete pas Irakut me 11,086 dokumente sekrete. Siç del nga klasifikimi i vendeve të përfshira në “Hiroshimën” Wikileaks, Iraku mban vendin e parë me 15,365 dosje sekrete. Publikimi i dokumenteve ka zemëruar Uashingtonin: Shtëpia e Bardhë, nëpërmjet një deklarate të botuar thotë, se “një zbulim i tillë i rrezikon diplomatët, profesionistët e inteligjencës dhe popullin në mbarë botën, që vijnë në Shtetet e Bashkuara për ndihmë, në promovimin e demokracisë dhe të qeverisë së hapur”. /Balkanweb/ ■

“ATDHEU” TURPËRON ARIEL SHARONIN

Filmi “Atdheu” i regjisorit holandez Xhorxh Silvester ka nxitur debat në festivalin ndërkombëtar të filmit dokumentar në Amsterdam, i cili përfundoi më 28 Nëntor.

Ky film kishte dokumentuar vrasjen e dy fëmijëve palestinez në kampet Sabra dhe Shatila në Liban në vitin 1982 nga ish-kryeministri izraelit Ariel Sharon. Filmi arriti një përqindje të lartë shikueshmërie, gjë e cila bëri që festivali ta shfaqë tri herë ndërsa ishte paraparë të ndodhë një herë. Publiku e përjetoi filmin me duartrokitje të rrufeshme sa herë që shfaqej, madje edhe numri i ndjekësve të festivalit u rrit dukshëm.

Regjisorin për “Al Jazeera.net” theksoi: “Nuk ishte e rëndësishme realizimi i fitores në këtë festival aq sa ishte e rëndësishme ajo që njerëzit ta njohin nga afër fatkeqësinë e një populli që humbi atdheun. Nëse jo të gjithë që e shikuan filmin u solidarizuan me fatkeqësinë e palestinezëve, sigurisht 99% e tyre po”. /islaammemo.cc/ ■

INICIATIVË E MUSLIMANËVE TË ZVICRËS PËR TË SHFUQIZUAR NDALESËN E MINAREVE

Një vit pas referendumit për të ndaluar minaret në Zvicër, Këshilli Qendror Islam në Zvicër, në 29 Nëntor 2010 lajmëroi se do të ndërmerr një iniciativë popullore, që synon shfuqizimin e vendimit që ndalon ndërtimin e minareve në shtetin zviceran. “Nëse duam të anulojmë ndalesën e ndërtimit të minareve në Zvicër, këtë duhet ta bëjmë në të njëjtën mënyrë siç u arrit ajo ndalesë” – u shprehën nga Këshilli. Ata shpejtojnë që më së voni në fund të Dhjetorit të këtij viti të formojnë Këshillin e Gjerë Iniciues dhe për këtë kanë kontaktuar me personalitete nga rrafshi politik, kulturor dhe nga ai i biznesit. Kërkesa brenda 18 muajsh duhet të tubojë 100,000 nënshkrime dhe pastaj t’ia parashtrijë Administratës Federale. /almoslim.net/ ■

NDËRTIMI I RRETHIT TË ARTË

Unë besoj se stimulimi material ndihmon në rritjen e kreativitetit, në nxitjen e zhvillimit... dhe gjithashtu nuk duhet të harrojmë, se edhe nëpunësi më i ulët ka familje, ka detyrime që shpeshherë nuk dallojnë prej detyrimeve që ka edhe nëpunësi i lartë.

DR. ABDULKERIM BEKAR

Rëndësia e ndërtimit të rrethit të artë buron nga vizioni i përgjithshëm për nevojat, aspiratat, dëshirat dhe kufijtë e durimit dhe përballimit tek njeriu. Njerëzit në esencë janë krijesë e dobët, imituese. Për këtë shkak kufizimi i mjedisit më të përshtatshëm për një jetë të qetë produktive është në krye të agjendës së reformuesve. Ata janë të vetëdijshëm për faktin se këshillimi i njerëzve për mirësi, seriozitet, rritje të prodhimit nuk është i mjaftueshëm në një shoqëri në të cilën mungojnë faktorët elementarë për realizimin e asaj që kërkohet prej tyre.

Planet zhvillimore serioze në vete i ngërthejnë kushtet e rrethit të artë dhe mundohen ta realizojnë atë.

Si ndërtohet rrethi i artë?

Para se t'u drejtohem njerëzve me thirrjen, që të kryejnë ndonjë detyrim dhe para se t'i detyrojmë të pranojnë ndonjë parim moral, duhet t'ua tregojmë edhe mjetet që mundësojnë realizimin e kërkesave tona. Kjo çështje është me rëndësi të madhe. Mundësitë dhe shanset janë të shumta, por shumë prej njerëzve, në veçanti të rinjtë nuk kanë informata rreth tyre. Për këtë shkak prej intelektualëve dhe krijuesve të opinionit kërkohet që të janë më praktikë, se sa janë në këto rrethana.

Të angazhohemi në krijimin e klasës së mesme, e cila do të jetë e fuqishme dhe me shtrirje të gjerë. Individët e kësaj klase janë ata që e kanë kaluar fazën e varfërisë, por nuk

kanë arritur të bëhen pjesë e klasës së lartë, ku bëjnë pjesë pronarët e pasurive të mëdha. Shumica e individëve të kësaj klase janë të arsimuar me profesione si mjekë, inxhinierë, avokatë, administratorë...

Përgjatë historisë ka qenë klasa e mesme ajo që u ka dhënë shoqërive tiparet kryesore, prej saj dilnin prodhues kreativë dhe liderë me ndikim në zhvillimin civilizues. Caku është që klasa e mesme të jetë 80% prej popullatës në përgjithësi. Ajo do të bëhet lidhja e fortë efektive mes klasës së ulët dhe klasës së lartë, do të luajë rolin e saj në stabilizimin dhe përforcimin e shoqërisë. Zgjerimi i kësaj klase prej neve kërkon disa çështje, si në vijim:

-Lufta e pamëshirshme kundër të gjitha formave të korrupsionit financiar dhe administrativ. Korrupsioni pengon zhvillimin atyre që janë të dobët dhe në të njëjtën kohë u jep mundësi të forcohen ata që janë të pasur dhe në pozita. Kjo si pasojë do të ketë zvogëlimin e klasës së mesme. Mua më mërzit realiteti, i cili thotë: shumica e vendeve muslimane paraqiten si shembuj në të cilët ndikimi i klasës së mesme është i dobët dhe si vende në të cilët dominon korrupsioni.

-Të kemi interes të veçantë ndaj avancimit të arsimit shtetëror/falas. Arsimi cilësor ndikon në lëvizjen e klasave dhe është hapësira më e gjerë për zhvillimin e klasës së mesme. Realiteti dëshmon për përparimin e shumë individëve nga klasa e mesme, që si zakonisht vijnë prej familjeve të varfra, për shkak të diplomave dhe diturisë që kanë përvetësuar me anë të arsimit. Të pikëllon fakti se arsimi shtetëror, i cili si zakonisht është falas dëshmon për një dobësim dhe dekadencë. Kështu të varfrit që nuk kanë mundësi të arsimohen me pagesë janë para një ardhmërie të paqartë. Në të njëjtën kohë të pasurit kanë rrugëdalje- arsimin privat për të cilin paguhen shuma marramendëse.

Shpresoj që fondacionet humanitare të

“...Të angazhohemi në krijimin e klasës së mesme, e cila do të jetë e fuqishme dhe me shtrirje të gjerë...”

ndajnë së paku 5% prej fondeve të tyre për të dërguar nxënës prej familjeve të varfra në universitete cilësore.

-kemi mundësi që qeveritë nëpërmjet buxheteve dhe tatimeve procedurale të marrin pjesë në zhvillimin e klasës së mesme. Këtu do të ndihmonte zvogëlimi i dallimeve në paga. Në vende stabël si Japonia është tejet normale që paga e përgjegjësit kryesor të jetë dhjetëfish më e madhe, se paga e nëpunësit të tij më të ultë. Nuk është normale si në disa vende arabe, ku paga e shefit të jetë në disa raste edhe mbi njëqindfish më e madhe se rroga e nëpunësit të tij më të ulët. Ky është një realitet i frikshëm. Unë besoj se stimulimi material ndihmon në rritjen e kreativitetit, në nxitjen e zhvillimit... dhe gjithashtu nuk duhet të harrojmë, se edhe nëpunësi më i ulët ka familje, ka detyrime që shpeshherë nuk dallojnë prej detyrimeve që ka edhe nëpunësi i lartë. Qeveritë kanë mundësi të ndihmojnë klasën e mesme me anë të bankave, që do të stimulojnë zhvillimin e zonave rurale, që do të sponsorizojnë projekte të vogla, që do të ndihmojnë studentët t'i kryejnë studimet e tyre. India gjatë një periudhe të zhvillimit të saj votoi ligjin sipas të cilit shteti ishte i detyruar t'i kryejë projektet e veta me anë të kompanive të vogla. Qëllim ishte të rikthehet baraspesha ekonomike në shoqëri.

Krahas kësaj propozoj të ndahen paga edhe për të papunët, kjo për të parandaluar shpërbërjen e familjeve dhe devijimin e tyre...

Biseda jonë e ka vazhdimin e saj... ■

Përktheu: Talha KURTISHI



SPROVA E DYSHIMEVE

Sprovat të cilat i paraqiten njeriut janë dy llojesh: sprovat e dyshimit dhe sprovat e epsheve, të dyja këto i kanë shkaqet, pasojat dhe kurimin, por meqenëse jemi në rubrikën e akides, do të qëndrojmë me sprovat e dyshimit, edhe për faktin tjetër se këto lloj sprovash janë edhe më të rëndat e më të rrezikshmet.

SHKRUAN: BLEDAR HAXHIU

Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi vulën e profetëve, Muhamedin,

familjen e tij të nderuar, shokët e tij besnikë dhe të gjithë ata që ndjekin rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Është një gjë e përcaktuar nga Allahu, që njeriu të sprovohet, madje prova është një përcaktim dhe sjellje hyjnore, e

cila mbart në vetvete një sërë urtësish, një pjesë të cilave njeriu arrin t'i zbulojë, por një pjesë prej tyre janë të panjohura për ta. Dhe një gjë është e ditur, dhe e qartë, se kush del me sukses, dhe i kalon këto sprova, patjetër që besimi i tij është kalitur, gradët e tij janë rritur dhe Ditën e Gjykimit ky njeri do të jetë i mikpritur nga Allahu. Pra, Allahu e ka bërë sprovën pjesë të kësaj jete, u sprovua njeriu i parë dhe babai i njerëzimit, kështu që të gjithë do të vihem i në provë; Allahu thotë: ***“Elif, Lâim, Mîm. Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?! Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që Allahu t'i dallojë ata që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë”***.¹

Sprovat të cilat i paraqiten njeriut janë dy llojesh: sprovat e dyshimit dhe sprovat e epsheve², të dyja këto i kanë shkaqet, pasojat dhe kurimin, por meqenëse jemi në rubrikën e akides, do të qëndrojmë me sprovat e dyshimit, edhe për faktin tjetër se këto lloj sprovash janë edhe më të rëndat e më të rrezikshmet.

Imam Ibën Kajim el Xheuzije -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë: “Sprovat janë dy llojesh: sprovat e dyshimit, të cilat janë nga sprovat më të rënda dhe sprovat e epsheve, ato mund të bashkohen tek një njeri i vetëm, por edhe mund të ndahen -pra të jetë tek ai njëra prej tyre-”.

Ndërsa Imam Abdulaziz Ibën Baz -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë:³ “Sprovat

“...Sprovat e dyshimeve janë më të rrezikshmet, sepse ndodh shpeshherë që njeriu për shkak të një dyshimi të braktisë fenë e tij...”

e dyshimeve janë më të rrezikshmet, sepse ndodh shpeshherë që njeriu për shkak të një dyshimi të braktisë fenë e tij. Dhe sprovat e dyshimeve janë të shumta, prej tyre kanë lidhje me Allahun e Lartësuar, Krijuesin e Gjithësisë; ka prej tyre që kanë lidhje me Profetin *salAllahu alejhi ue selem*; prej tyre kanë lidhje me Kuranin; ka prej tyre që kanë lidhje me urdhëresat dhe ndalesat. Kështu vazhdojnë armiqtë e kësaj feje të dialogojnë me muslimanë të ndryshëm, në lidhje me fenë e tyre, duke hedhur kështu në zemrën e tyre farërat e së keqes dhe i fusin në dyshim në lidhje me fenë e tyre duke u thënë, përse kjo kështu e përse ajo ashtu? Ku gjendet kjo dhe ku është argumenti për këtë? Kështu vazhdojnë me ta derisa t'i devijojnë nga feja e tyre e të shkatërrohen, si pasojë e injorancës që kanë në lidhje me fenë e tyre.

Më poshtë ai vazhdon e thotë: “Të gjitha këto janë sprova për të cilat na ka tërhequr vërejtjen i Dërguari i Allahut *salallahu alejhi ue selem*, -sprovat e dyshimeve, sprovat e epsheve dhe

¹ Sure Ankebut: 1-3.

² Tek grupi i parë i këtyre sprovave kanë rënë të krishterët, ndërsa tek i dyti kanë rënë çifutët, e për sa i përket këtij umeti prej tyre ka që ecin të patrembur në rrugën e drejtë, por prej tyre ka që kanë rënë në sprovën ku ranë të krishterët e prej tyre ka që kanë rënë në sprovën ku ranë çifutët. Allahu na ruajtë nga sprovat.

³ Shkëputur nga mësimet e tij në audio.

shkaqet e luftës dhe vëllavrasjes-, ku thotë: *“Shpejtoni në kryerjen e punëve të mira para se të shfaqen sprova si copëza të natës së errët, në të cilat njeriu gdhiet besimtar dhe ngryset jobesimtar; ngryset besimtar dhe gdhiet jobesimtar, duke shitur fenë e tij për ndonjë qëllim të kësaj bote.”*

Cilat janë shkaqet e rënies së muslimanëve në këto sprova dhe pse ndikojnë ato tek muslimanët?

Imam Ibën Kajim el Xheuzije -Allahu e mëshiroftë-, mundohet t'i japë një përgjigje kësaj pyetjeje, kur na thotë: *“Shkaku i rënies në sprovat e dyshimeve është jo-vigjilenca dhe dija e pakët, sidomos kur ato shoqërohen nga qëllimi i prishur dhe mos arritja e udhëzimit. Sigurisht që kjo është sprova e vërtetë dhe katastrofa e madhe, dhe mund të thuash ç'të duash për humbjen e atij që ka qëllim dashakeq, të cilin e kontrollon epshi dhe jo udhëzimi, shtoi kësaj jo-vigjilencën dhe paditurinë rreth asaj me të cilën Allahu dërgoi Profetin e Tij. Ky njeri është pikërisht nga ata për të cilët Allahu thotë: **“Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi...”**”⁴*

Realisht Ibën Kajimi nuk ka bërë gjë tjetër, veçse ka shtjelluar shkaqet e dyshimeve prej të cilave na ka tërhequr vërejtjen i Dërguari i Allahut *sallallahu alejhi ue selem*, i cili ka thënë në hadithin që përcjell Muavija dhe Ebu Hurejre: *“Janë përçarë çifutët në shtatëdhjetë e një grupe, janë përçarë të krishterët në shtatëdhjetë e dy grupe dhe do të*

“Pra, nëse besimtari kërkon që të shpëtojë nga sprova e dyshimeve, ai patjetër që ka nevojë të shtojë dijen, të pas-trojë qëllimin, të forcojë bindjen dhe të realizojë nënshtrimin...””

përçahet umeti im në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjitha do të jenë në zjarr përveç njërit, të cilët janë ata që veprojnë atë që jam unë dhe shokët e mi sot”.⁵ Apo në hadithin tjetër: *“Do të dalin nga umeti im disa njerëz, të cilët do t'i shtrëngojnë sprovat, ashtu sikurse shtrëngon tërbimi atë që e ka zënë, tek i cili nuk lë venë e nyje pa shkuar...”*.⁶

Dhe realisht po të hedhësh vështrimin në shkaqet e përçarjes, devijimit dhe rënies në sprovat e dyshimit përgjatë të gjithë historisë, do të gjesh se shkaku kryesor është plotësimi i tekave, mosnjohuria e teksteve, përdorja e logjikës, qëllimi dashakeqës, kundërshtimi i argumenteve dhe ndikimi i këtij umeti nga filozofitë e popujve të tjerë.

Nëse do të vështrosh me kujdes në botën islame do të gjesh gjithfarësoj sektesh, fraksionesh dhe grupesh, të cilat kanë devijuar në besimin e tyre në Allah dhe bazat e tjera të besimit me radhë, të cilët lëngojnë nga sprovat e dyshimeve, sikurse ai që lëngon nga tërbimi. Krerët e

⁴ Sure Nexhm: 23.

⁵ Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ibnu Maxhah.

⁶ Ahmedi, Ibën Ebi Asimi dhe Hakimi, e ka saktësuar Albani.

këtyre grupeve e sekteve kanë qenë ose dashakëqij, si Abdullah bin Sebei⁷, ose mospranues e kundërshtues si Abdullah dhi Huvejsira Temimi⁸, ose injorantë të cilët kanë humbur veten, por që kanë humbur edhe të tjerët. Allahu na ruajt nga sprovat e dyshimeve dhe thirrësit e tyre.

Si largohen dhe evitohen sprovat e dyshimit?

Imam Ibën Kajimi Allahu e mëshiroftë ka thënë: “Sprova e dyshimit largohet me siguri dhe bindje, ndërsa sprova e epsheve largohet me durim, ndaj dhe Allahu i Lartësuar e bëri prijësinë në fe të kushtëzuar prej këtyre dy faktorëve: **“Ne zgjodhëm prej tyre prijës, të cilët udhëzonin me urdhrat Tanë, për sa kohë që ishin të durueshëm dhe besonin bindshëm”**.”⁹ Po ashtu i ka shoqëruar edhe në ajetin: **“Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëritjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëritjetrit durimin”**.”¹⁰ Me këshillimin për tek e vërteta arrihet largimi i dyshimeve, ndërsa me këshillimin për durim largohen epshtet”.

Pra, nëse besimtari kërkon që të shpëtojë nga sprova e dyshimeve, ai patjetër që ka nevojë të shtojë dijen, të pastrojë qëllimin, të forcojë bindjen dhe të realizojë nënshtrimin. Të veprojë pikërisht ashtu sikurse na orienton

Profeti *salAllahu alejhi ue selem*, në hadithin që e përcjell Ebu Hurejre, ku thotë: *“Shejtani vjen tek ndonjëri prej jush dhe i thotë: Kush e ka krijuar këtë e atë, derisa t’i thotë kush e ka krijuar Zotin tënd? Nëse dikush e has këtë, le të kërkojë mbrojtje nga Allahu dhe t’i japë fund asaj”*.¹¹

Po ashtu duhet të kapet fort pas teksteve kuranore dhe të zbatojë traditën profetike, e duke zbatuar kështu porosinë e Profetit tonë, i cili na thotë: *“Ju porosis të pasoni Sunetin tim dhe traditën e halifëve të drejtë pas meje, kapuni pas saj fort me dhëmballë dhe kini kujdes nga shtesat në fe, sepse çdo shtesë është humbje”*.¹²

Nga ilaçet e parandalimit të dyshimeve është largimi dhe mos dialogimi me të devijuarit. Një herë dikush shkoi tek Hasan Basriu dhe i tha: “O Ebu Seid! Unë dua të dialogoj me ty?- Hasani ia ktheu: - “Shko dhe hiqmu, sepse unë e njoh si duhet fenë time, shko e dialogo me ata të cilët kanë dyshime në fenë e tyre”.¹³

O Allah! Ne kërkojmë mbrojtje dhe strehohemi tek Ti prej sprovave, prej atyre sprovave që shfaqen e edhe atyre të fshehtave. O Allah! Mos na lër të biem në sprova, që na shkatërrojnë fenë tonë. Shtoje tek ne bindjen dhe nënshtrimin ndaj Teje o Zot i gjithësisë. ■

⁷ Çifut nga Jemeni, i cili u shfaq si musliman në kohën e Osmanit e që mbolli vrer, dyshime dhe devijime te muslimanët e thjeshtë, i cili e konsideroi Aliun edhe Zot e nga ku e ka burimin dhe sekti i Rrafidave (Shiave të Iranit).

⁸ Ky person në një nga luftërat iu drejtua Profetit për plaçkën e luftës duke i thënë: “Mbaj drejtësi, o Muhamed”, duke e kundërshtuar kështu Profetin. Prej këtij njeriu kanë dalë e rrjedhur Huarixhët, edhe pse duhet thënë se nuk është ky themeluesi i tyre si grupim, sepse si grupim ata janë shfaqur në kohën e Aliut.

⁹ Sexhde: 24.

¹⁰ Asër: 3.

¹¹ Muslimi.

¹² Muslimi.

¹³ Sherh Usul el Itikad i Lalekait 1/128.


ZEMËRIMI NGA KAPLIMI I FATKEQËSIVE

Durimi është përmbajtja e vetvetes nga zemërimi, një gjë e tillë shpesh është tepër e vështirë për epshin, porse një gjë e tillë është detyrim. Po qe se njeriu nuk bën durim nga zemërimi, atëherë mund të bjeri në mëkate të mëdha

MUHAMED IBËN SALIH UTHEJMIN

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të gjithësisë, salavatet dhe selamet qofshin mbi profetin tonë Muhamedin, familjen e tij, shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit. Një prej bazave të besimit islam është besimi i njeriut në kader (caktimin e Allahut) qoftë ai i mirë apo i keq. Si dhe ta dijë, se ajo që e ka kapluar nuk ka pasur mundësi të mos i ndodhë, ndërsa ajo që nuk e ka kapluar, as që ka pasur mundësi t'i ndodhë dhe se çdo gjë kthehet tek Allahu. Pa dyshim që në sprovimin e robit qoftë në të mirë apo në të keqe qëndron urtësia e pafund e Allahut Fuqiptotë, prandaj fatkeqësitë janë dy llojesh:

Lloji i parë: ky lloj ia shlyen mëkatet personit dhe ia përmirëson gjendjen e tij.



Allahu në Kuran thotë: *“Çfarëdo e keqe që mund t’ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai ju fal.”* (Shura: 30) si dhe fjala e Allahut: *“Për shkak të veprave (të këqija) të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në det të zeza (bela, skamje, katastrofa, humbje e bereqetit etj.), e për ta përjetuar ata një pjesë të asaj të keqeje që e bënë, ashtu që të tërhiqen (nga të këqijat).”* (Rum: 41).

Lloji i dytë: Fatkeqësitë mund të jenë shkas për ngritjen e gradave të njeriut që ai të arrijë e të pajiset me cilësi të lartë, pra me durimin për të cilin Allahu i lavdëron ata që

e kanë këtë cilësi, kur na thotë: **“...ndërsa të durueshmëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!”** (Zumer: 10).

E njëjta gjë vlen me sprovat e të Dërguarit të Allahut- paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, kur u sëmuri ai e kishte dhimbjen e dyfishtë në krahasim me njerëzit e tjerë. Kjo i ndodhi kështu atij me të vetmin qëllim që ai të arrijë gradat më të larta të durimit, pra të arrijë vlerën për të cilën jep lëvdata Allahu i Lartësuar, e pa dyshim se ai e ka arritur atë gradë. E kjo është e vërtetë, ngase ai ishte njeriu me durim më të madh në bindjen ndaj Allahut, njeriu më durimtar në ndalesat e Allahut, si dhe njeriu, i cili ka bërë durimin më të madh ndaj fatkeqësive që i ndodhën atij.

Nga kjo hyrje nënkuptojmë, se njeriu e ka detyrim të bëjë durim në caktimin e Allahut, sepse zemërimi - urrejtja me atë që të ka caktuar Allahu llogaritet dobësi e besimit në rububijetin - Zotërimin e Allahut, ngase kuptimi i saj është se Allahu bën çfarë të dojë. Pastaj shiko e medito mbi mirësinë e Allahut, kur Ai bën me robin e Tij çfarë të dojë po ashtu në të njëjtën kohë e shpërblen për fatkeqësitë që i kanë rënë, po qe se bën durim dhe shpreson në shpërblimin e Allahut. Disa dijetarë kanë thënë: Njerëzit në fatkeqësi ndahen në katër grupe:

1 - Të zemëruarit

2 - Durimtarët gjatë sprovave dhe fatkeqësive

3 - Të jesh i kënaqur me sprovat dhe fatkeqësitë

4 - Falënderuesit ndaj asaj që ua ka caktuar Allahu i Lartësuar.

1 - Zemërimi

Sa i përket zemërimit kjo është e ndaluar, qoftë me zemër, me gojë apo me gjymtyrë. Zemërimi me zemër është të mendosh, se Allahu i ka bërë padrejtësi me këtë fatkeqësi dhe se ky nuk është njeri që meriton të sprovohet në këtë mënyrë. Ky

“Zemërimi me zemër është të mendosh, se Allahu i ka bërë padrejtësi me këtë fatkeqësi dhe se ky nuk është njeri që meriton të sprovohet në këtë mënyrë...”

person është në rrezik të madh pasi Allahu thotë: **“Ka nga njerëzit që e adhuron Allahun me mëdyshje (luhatshëm), nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet më të, por nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai i ka humbur këtë dhe jetën tjetër e ky është ai dështimi i qartë.”** (Haxh: 11). Kurse zemërimi me gojë është të bërtasësh me fjalë injorance (xhahilijeti), si p.sh.: Ah shkatërrimi im, ah humbja ime, e të ngjashme me to fjalë vajtimi, të cilat tregojnë se robi është i zemëruar dhe nuk është i kënaqur me caktimin e Allahut. Ndërsa zemërimi me gjymtyrë është: t'i mëshosh fytyrës me shuplaka, shqyerja e teshave etj. Prej këtyre njerëzve është distancuar edhe i Dërguari i Allahut- paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, duke thënë: **“Nuk është prej nesh ai që gris rrobat, i mëshon me shuplaka fytyrës dhe ai që bërtet fjalë xhahilijeti.”** Prandaj ky lloj zemërimi është haram, madje prej mëkateve të mëdha, ndërsa zemërimi me zemër është më i rrezikshmi.

2 - Durimi

Durimi është përmbajtja e vetvetes nga zemërimi, një gjë e tillë shpesh është tepër e vështirë për epshin, porse një gjë e tillë është detyrim. Po qe se njeriu nuk bën durim nga zemërimi, atëherë mund të bjeri në mëkate të mëdha. I Dërguari i Allahut-

paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, i ka thënë një gruaje, e cila e ka thirrur të Dërguarin e Allahut-paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, ta vizitojë djalin e saj në momentin e vdekjes, e ai u ka thënë për të, që ta keshillojnë me fjalët: *“Urdhërojeni atë të bëjë durim e të shpresojë në shpërblimin e Allahut.”*

3 - Kënaqësia

Të jetë i kënaqur rob me atë që i është caktuar nga fatkeqësitë plotësisht. Në këtë çështje dijetarët kanë debatuar se vallë: a është detyrim kënaqësia me të? Mendimi më i saktë është se kënaqësia në të është e preferuar, ngase kur njeriun e kaplon ndonjë fatkeqësi automatikisht nuk është i kënaqur me të, e si pasojë nga ajo çfarë i ka ndodhur ai duhet ta përmbajë veten nga zemërimi. Ndërsa kënaqësia është kur të të mos vijë aspak keq për atë që të ka kapluar, prandaj ajo që i vjen nga Allahu, ai është i kënaqur me të, pra ai është i kënaqur me caktimin e Allahut ndaj tij, qoftë ai i hidhur apo jo, për të është njësoj. Sikur ai dëshiron të thotë: Unë jam rob i Zotit tim, e Ai është Zoti im, unë jam i kënaqur me të mirën e Tij, e falënderoj Allahun, e po qe se më ndodh diçka tjetër përsëri unë jam rob i Tij, prej meje ai ka durim dhe falënderim. Apo ndoshta sprovën e sheh si shlyerje mëkatesh dhe shpërblim, në këtë kontekst përmendet rasti i Rabie Adevijes. Na përcillet se ajo është sprovuar në gishtin e saj, e nuk është ankuar aspak, e kur është pyetur, se pse vallë nuk ankohet, ajo është përgjigjur duke thënë: Ëmbëlsia e shpërblimit të saj më bën ta harroj hidhësinë e saj me durim ndaj saj.

4 – Falënderimi

Kur ta kaplojë ndonjë fatkeqësi apo sprovë e falënderon Allahun për atë që i ka ndodhur. Por shpesh kjo është e rëndë, sepse kur i ndodh njeriut ndonjë sprovë,

“Kënaqësia është kur të të mos vijë aspak keq për atë që të ka kapluar, prandaj ajo që i vjen nga Allahu, ai është i kënaqur me të...”

natyra e njeriut nuk e pranon një fenomen të tillë aq lehtë. Mirëpo kur mediton e logjikon mund të ndodhë, që njeriu ta falënderojë Allahun për këtë fatkeqësi, duke menduar se ka pasur mundësi t'i ndodhë diçka më e madhe, prandaj ky e falënderon Allahun që nuk e ka sprovuar me diçka më të madhe, P.sh. dikush pëson aksident dhe thyen këmbën, kur shikon trupin e tij thotë: Falënderimi i takon Allahun, që nuk pësova ndonjë dëmtim më të madh, e të kisha mbetur me të meta etj. Pra çdoherë e mendon se sprova e tij mund të ishte edhe më e rëndë. Prandaj nga kjo sprovë ai sheh se ajo është sprovë dhe se pas pak kohësh do të shërohet prej saj. Ose prej saj i vjen vdekja (exheli) çfarë i ka caktuar Allahu Fuqiplotë, kështu që ky e falënderon Allahun dhe në çdo rast arrin shpërblimin e Allahut të Lartësuar. Prandaj njeriu në fatkeqësi mund t'i takojë njërit prej këtyre katër grupeve:

1 - Zemërimi për atë çfarë i ka ndodhur, pra nuk është i kënaqur me sprovën, madje është i hidhëruar, kjo është haram.

2 - Durimi në sprova, është detyrim.

3 - Kënaqësia në sprovë, është e pëlqyer.

4 - Falënderimi i Allahut gjatë sprovës, kjo është grada më e lartë për besimtarin.

Allahu e di më së miri, salavatet dhe selamet qofshin mbi profetin tonë Muhamedin, familjen dhe shokët e tij. ■

Përktheu dhe përshtati: Nexhat Ceka

SEKRETI I FSHEHUR

Ta marrim si shembull Abdullah ibën Mesudin. Ai ka qenë një çoban nga periferia e Mekës. Gjatë historisë ka pasur me mijëra e miliona çobanë të tjerë. Mirëpo kur ky çoban dhe sahabet e tjerë kanë besuar dhe e kanë përqaftuar Islamit janë shndërruar në diçka të pabesueshme.

SEFER IBËN ABDURRAHMAN EL-HAVALI

Ne mund ta argumentojmë ekzistencën e këtij sekreti me fakte konkrete përmes fjalëve të atyre, të cilët nuk besojnë në ahiret, por besojnë në aktivitet dhe në energji dhe gjithashtu besojnë në nevojën e shfrytëzimit racional të kohës së tyre. Qëllimi i këtij prezantimi është thjesht rritja e diturisë tuaj dhe pastaj të bëni krahasimin.

Janë bërë shumë hulumtime për ta studiuar potencialin njerëzor, si p.sh.: madhësinë dhe fuqinë e këtij potenciali. Për këtë shkak nga kjo temë të gjithë mund të përfitojmë. Të gjithë ata që e studiojnë qenien njerëzore dhe potencialin e tij të fshehur thonë se ky potencial është diçka shumë e veçantë. Çdo njeri ka rezerva jashtëzakonisht të mëdha të mundësive dhe të energjisë. Ta shikojmë një njeri normal me inteligjencë mesatare. Nëse këtij personi i ngacmojmë potencialin e fshehur, ai mund të bëhet njëri prej gjenive më të mëdhenj, më i madh se sa mund ta imagjinojmë, mund të bëhet

njëri prej liderëve më të mëdhenj botërorë, është e mundur të bëhet njëri prej shkencëtarëve më të shquar botërorë. Si mund të ndodhë kjo? Thuhet se ky potencial ekziston, por ruhet i depozituar. Pra, duhet që të ngacmohet disi dhe të nxirret jashtë.

Sa për ilustrim mund të marrim shembullin e garës në vrapimin në distanca të largëta (maratona – një nga praktikat e Greqisë antike injorante). E kanë bërë si rit fetar, duke bërë gara rreth Olimpët, sipas tyre mal i shenjtë, duke menduar se aty jetojnë “zotat”. Të gjitha këto besime janë të rrejshme, të cilat që prej asaj kohe janë përhapur anekënd botës. Pra, nëse dikush bën garë në dhjetë ose njëzet kilometra dhe pas shpenzimit të tërë energjisë, tërhiqet nga gara, mjekët (të cilët e kontrollojnë) do të thonë se ky garues ka akoma energji rezervë të fshehur – rezerva të energjisë natyrore organike, energji e cila është e pakufishme. Në realitet kjo është diçka e pabesueshme.

Mirë pra, cili është argumenti për këtë energji

“...Sa herë dëshiroj të fle, e përkujtoj Xhenetin ose Xhehenemin dhe kërcej si i trembur, paçka se s’kam mundur të bëj gjumë...”

rezervë?

Thuhet se nëse dikush është në garë dhe pas lodhjes së madhe që ka kaluar dhe tërheqjes së tij nga gara, e vëren atë një luan i uritur, i cili e sulmon për ta kafshuar, ky garues do të çohet dhe do të iki me shpejtësi të madhe. Çdo lavdërim i takon Allahut! Nga i vjen kjo energji? Mos vallë i zbret nga qielli? Thuhet se ky është argumenti për ekzistencën e rezervave të fshehura të energjisë, dhe garuesi ka mundësi t’i shfrytëzojë në momentin kur e humb rastin për ta fituar garën. Faktori kryesor është çfarëdo gjëje, që i nxit këto rezerva dhe i nxjerr jashtë. Nëse ky faktor është prezent dhe i fuqishëm, këto rezerva do të jenë në dispozicion në masë të madhe.

Çfarë ndodh nëse këto principe i zbatojmë në realitetin e gjeneratës së parë, gjeneratës së sahabeve? Çfarë kanë qenë ata? Ata kanë qenë beduinë të thjeshtë, si çdo arab tjetër. Kanë qenë nga fisi Kurejsh, të çiltër si edhe njerëzit tjerë. Shikoni si janë shfrytëzuar aftësitë dhe potenciali i tyre, kur janë bërë

besimtarë dhe kanë hyrë në Islam! Ta marrim si shembull Abdullah ibën Mesudin. Ai ka qenë një çoban nga periferia e Mekës. Gjatë historisë ka pasur me mijëra e miliona çobanë të tjerë. Mirëpo kur ky çoban dhe sahabet e tjerë kanë besuar dhe e kanë përqafuar Islamin janë shndërruar në diçka të pabesueshme. Ai, Abdullah ibën Mesudi, ka arritur të bëhet njëri prej dijetarëve më të njohur në qytetin e Kufes në shtetin islam, të njohur në të tërë botën. Njerëzit kanë udhëtuar nga vende të largëta për në Kufe, vetëm e vetëm ta vizitojnë Abdullah ibën Mesudin, **çobanin!** Si është shfrytëzuar potenciali i tij dhe si është aktivizuar energjia e tij e fshehur?

Me të vërtetë kjo temë ka lidhje të ngushtë me elementin, i cili e aktivizon dhe e nxjerr jashtë këtë energji të fshehur. Ky faktor nxitës ka arritur gjer te sahabet (e lus Allahun Fuqiplotë, që në zemrat tona të na e dhurojë këtë gjë), dhe kurrë s’mund ta shihni që ndonjëri prej tyre e kërkon Xhenetin, ose ikjen nga Xhehenemi duke fjetur.

Njëri nga selefi ka thënë: “Sa herë dëshiroj të fle, e përkujtoj Xhenetin ose Xhehenemin dhe kërcej si i trembur, paçka se s’kam mundur të bëj gjumë”.

SubhanAllah, duke lexuar Kuran dhe duke falur namaz, dëshironte të ulej dhe të pushojë, e në atë çast e kujtonte përpjekjen në rrugë të Allahut, urdhëresën në të mirë dhe ndalimin nga e keqja, ose ndonjë vepër tjetër të mirë. Si mund të gjesh kohë për pushim, kur kjo gjë për ata ka qenë faktor i madh i nxitjes? Allahu është i lavdëruar dhe i falënderuar për këtë natyrë që ka besimtari. Mund të ndodhë që ndokush të jetë në gjumë në shtratin e tij, dhe e thërret ndonjëri nga vëllezërit e tij për ta ndihmuar, ai zgjohet dhe me një entuziazëm të pasiq e kryen atë detyrë. E njëjta gjë ndodh edhe të mos ishte në gjumë, por në ndonjë punë. Ai do ta linte punën e tij dhe do të angazhohej ndoshta edhe me orë të tëra për vëllanë e tij. Dhe kështu e kuptojmë sekretin e suksesit të sahabeve, sepse i tërë potenciali i tyre është shfrytëzuar maksimalisht. Ekziston Xheneti, e ti dëshiron të flesh?!... dhe përnjëherë të kujtohen hyritë dhe shërbëtorët e Xhenetit. Mu sikurse ka thënë njëri prej sahabeve: “A me të vërtetë mes meje dhe Xhenetit qëndron vetëm vdekja ime?”. I hedh hurmat që kishte në dorë dhe vërsulet në betejë, sepse ishte Xheneti i tij. Shtyrja dhe stimulimi më i madh për ty është përkujtimi i Xhenetit dhe të vazhdosh të punosh vepra të xhenetlive, ose ta përkujtosh Xhehenemin dhe të largohesh nga veprat e xhehenemlive.

Për shkak të këtyre gjërave besimtari mund të largohet nga epshet e forta, të cilat i bëjnë presion të madh, mu ashtu siç ndodhi me të Dërguarin e Allahut, Jusufin. Kjo gjithashtu ndodhi edhe me njeriun e ngjuar në shpellë, të cilit i kishte ardhur kushërira me të cilën ishin krejt afër

“...Shtyrja dhe stimulimi më i madh për ty është përkujtimi i Xhenetit dhe të vazhdosh të punosh vepra të xhenetlive, ose ta përkujtosh Xhehenemin dhe të largohesh nga veprat e xhehenemlive...”

kurvërisë, dhe ajo i thotë: “Ki frikë Allahun, mos ma merr virgjërinë në mënyrë të paligjshme!” Arriti frika e Allahut deri tek ai në momentin kur epshi i tij rritej, dhe u largua nga ajo vepër shumë e keqe për hir të Allahut. Sepse ajo çka arriti tek ai ishte më e fortë se çdo epsh e lakmi, dhe ishte më e fuqishme se cildo cytës. Për këtë shkak njeriu i le të gjitha gjërat dhe bëhet person i fortë dhe i qëndrueshëm, e shfrytëzon këtë energji dhe fuqi në diçka fisnike.

Njëri prej selefit, i cili ishte në moshë të shkuar ka qenë njeri shumë i devotshëm edhe në ato vite të jetës. Njerëzit të ngazëlluar thoshin: “Plaku i cili është në gjendje të jetë i dëlirë në këtë masë?!... E ai është përgjigjur: “I kam ruajt këto organe në rini e Ai – Allahu – po m’i ruan në pleqëri”. E pabesueshme!!! Energjia dhe potenciali akoma janë të pranishme!

Shikoje potencialin që Allahu na ka dhënë! Përqendrohu te kjo energji dhe do të zbulosh gjëra të mrekullueshme. Mirëpo kjo energji, e ky potencial janë si karburanti: nëse e len të derdhet në tokë, askush nuk ka dobi prej tij, por nëse e fut në veturën tënde dhe e fut në lëvizje motorin, makina me lejen e Allahut do të lëvizë. ■

E përshtati Zeki Çerkezi

PREZANTIM I LIBRIT:

NË PASQYRËN E OKSIDENTIT

**AUTOR: ENIS SULSTAROVA,
BOTUES: LOGOS-A, SHKUP, 2010.**

Enis Sulstarova, një studiues i ndikuar nga qasja saidiane, në mënyrë analitike dhe kritike shtron një problematikë me të cilën shqiptarët përballen ndër shekuj, atë të të qenit ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, çështjen e dilemës shumëshekullore shpesh të banalizuar skajshmërisht, sikur këto dy botë të ishin të ndara prerazi mes tyre

SHKRUAN: PROF. DR. ALI PAJAZITI

E*x Oriente Lux!* “Drita vjen nga Lindja”. Një thënie që interpretohet duke u nisur nga fakti se dielli del nga lindja e deri te hermeneutika mistike që vështirë se mund të shprehet me fjalë, meqë në radhë të parë i vë sytë e zemrës. Një nga



komentet që ndërlidhen me këtë sintagmë është edhe ai se Lindja ka dhënë fetë abrahamike (hebraizmin, krishterimin, islamin), qytetërimet dhe kultura të mëdha (babilonase, sumere, hitite, egjiptiane, hindu, budiste) etj. Sot ligjërimi mbizotërues është ai që e përjashton dhe e atakon Lindjen dhe lindoren, gjithnjë duke u nisur nga motoja *West is the best!*, kur

kemi lëkundje nga westcentrizmi letrar-scientist-publicist (Kadare, A. Xhaferi) deri tek ai patologjik (Myftaraj, Velo). Në këtë periudhë paskomuniste po ringjallet njëfarë historicizmi, në kuadër të të cilit intelektualët shqiptarë janë duke e riinterpretuar historinë shqiptare rrotull një njësie të quajtur “Evropë” apo “Perëndim”, që është nyja që përcakton pozitën e shënjesve të tjerë në ligjërime (f. 398).

Sot ndër shqiptarët Oksidenti dhe oksidentalizimi, çështja e arratisjes përfundimtare nga Lindja dhe ngjitjes në varganin e botës së parë, në atë që quhet Perëndim janë tema të rrahura me doza subjektivizmi dhe njëanshmërie, pra shoqërohen me një eufori të pop-kulturës masovike, ku të gjithë vrapojnë që të tregohen sa më westernistë, sa më pro euro-atlantikë, duke u përpjekur që të mbyllin sytë para identitetit të realit, që nuk është produkt i hëpërhëshëm dhe as i njëanshëm. Për pro-oksidentalët tanë Orienti është një kategori më pak gjeografike dhe më tepër politiko-ideologjike, një term që përshkruan një pjesë të botës që mendohet të jetë periferike, e prapambetur dhe për të mos e nxirë krejtësisht, edhe ekzotike. Megjithatë kjo pjesë e botës bashkë me kulturat dhe qytetërimet e krijuara ka ndikuar fort edhe në ngjizjen e botëkuptimeve dhe historive të Ballkanit në përgjithësi dhe të shqiptarëve në veçanti. Mund të thuhet se *homo balkanicusi* ka mbetur diku në mes Lindjes dhe Perëndimit.

Enis Sulstarova, një studiues i ndikuar nga qasja saidiane, në mënyrë analitike dhe kritike shtron një problematikë me të cilën shqiptarët përballen ndër shekuj, atë të të qenit ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, çështjen e dilemës

“Vepra në fjalë zbërthen vetëperceptimin e shqiptarëve, që sillet nga epërsia racore (miti i pellazgëve), të formësuar nga Rilindja Kombëtare Shqiptare sipas të cilit pellazgët janë bërthama e qytetërimit evropian...”

shumëshekullore shpesh të banalizuar skajshmërisht, sikur këto dy botë të ishin të ndara prerazi mes tyre. Ai i qaset identitetit shqiptar, si një identitet shumëstresor i mbetur mes ksenofilisë dhe vetëpëlqimit. Filozofia, antropologjia kulturore dhe politike që ndjek këtë libër është përpjekje për të lëvizur gurët në perceptimin mitik të vetes dhe filetizmit ndaj të tjerëve. Vepra në fjalë zbërthen vetëperceptimin e shqiptarëve, që sillet nga epërsia racore (miti i pellazgëve), të formësuar nga Rilindja Kombëtare Shqiptare sipas të cilit pellazgët janë bërthama e qytetërimit evropian, mitin e vetëfljimit për mbrojtjen e qytetërimit evropian nga pushtimi osman e deri te dilemat identitare dhe tendencat për të krijuar tjetrin brenda vetes (kultura muslimane dhe islami, xhamia, mbulesa).

Sulstarova duke bërë një sociologji dhe filozofi politike kombëtare trajton koncepte, si ndërgjegjja kombëtare, ideali i shqiptarisë, osmanizmi, përfytyrimet fetare, afritë fetare, sistemet kulturore, besimet fetare, laicizmi, armiku publik (lindja), mënyra e jetesës, shteti islam,

ymeti, programi kombëtar, mitizimi i atdheut, bosnizimi, trysnitë kulturore, helenizmi, greqizmi, osmanizmi, turkizmi, neoshqiptarizmi etj. Ai e trajton nga një perspektivë origjinale inxhinierinë politike dhe kulturore të shqiptarisë (Gellner, 2008: 72), duke u munduar t'i identifikojë çalimet konceptuale, që sjellin çalime aksionale.

Libri i Sulstarovës është i ndarë në tre kapituj, “Kombi dhe nacionalizmi shqiptar”, “Ideja e Evropës dhe orientalizmi” dhe “Kultura dhe politika në Shqipërinë komuniste”. Në të parin jepet një pasqyrë e ideve nacionaliste, që nga Rilindja (Veqilharxhi, Naimi, Fishta) e deri te kultura postmoderne e OJQ-ve (Vetëvendosje, Albin Kurti) dhe ideja e bashkimit kombëtar ndërmjet vegimit dhe realitetit, ku autori kapërcen *value-free sociology* dhe del në atë normative, shprehet *pro* projektit gjithëshqiptar. Në këtë kontekst shqyrtohet treshi: shteti osman, sistemi i miletit dhe nacionalizmi ortodoks grek në raport me shqiptarinë, rëndësia e gjuhës në zgjimin dhe ndriçimin e kombit, besën, barazinë politike dhe juridike të shqiptarëve pa marrë parasysh përkatësinë fetare.

Në kapitullin e dytë tema bosht është orientalizmi, i cili ndërldhur me kolonializmin paraqitet si një disiplinë, që i ka shërbyer hegjemonisë intelektuale perëndimore, që ka veshur me një mbulesë “shkencore” paragjykimet perëndimore mbi Orientin dhe orientalët. Veprat e Katerina Fleming, Maria Todorovës dhe Norman Cigarit janë ekzemplarë të vështrimit orientalist të botuara shqip. Ndërkohë ballkanizmi paraqitet si stigmë orientaliste në mikro-plan për një rajon si Ballkani. Sulstarova analizon edhe ligjëratën e orientalizmit shqiptar të brendshëm. Xheladin Beu, si simbol i

erosit oriental, si të kundërt nga ai “perëndimor” dhe Ali Pasha, perversi dhe despoti oriental janë dy figura të fantazive, trillimeve dhe paragjykimeve për Orientin.

Dhe kapitulli i fundit është një restrospektivë e iluzionizmit dhe *science fictionism*-it komunist shqiptar, që parashihte një ardhmëri superinteresante, vetëpëlqyese, utopiste të shoqërisë shqiptare të së ardhmes. Aty autori përmes terminologjisë së Sertosë (ekonomia e shkrimit), të Fukosë (burgu si metaforë sociologjike) i qaset ndërgjegjes klasore, propagandës dhe “krijimit të njeriut të ri”, marksizëm-leninizmit, për të cilën udhëheqësi ishte shprehur, se ishte “shkenca e shkencave, revolucioni i vazhdueshëm” dhe “rrethimi imperialisto-revizionist”, bajramin, kthimin e emërtimeve të vjetra, astronautët shqiptarë, trurit tim elektronik, vitin 2044, “cilatipakët”, (anagramë e fjalës “kapital”), telelogjia socialiste.

Nga e tëra që del si porosi nga vepra në fjalë me rëndësi të madhe është sentenca, se “duhet të lindë një elitë morale”, që do të bënte balancimin perceptimor dhe mendor, si të botës akademike ashtu edhe të grigjës. S’duhet harruar nevojën për *just memory*: historia të mos shikohet vetëm nga një kënd i vështrimit! Kanti mes të tjerash thekson nevojën për të përjashtuar paragjykimet, shmangiet dhe mashtrimet, me qëllim që të krijohet hapësira e njohjes së të vërtetës si e vërtetë. ■

(Panairi i Librit “Tiranë 2010”)

SI TË LLOGARITËSH ZEKATIN E PASURISË TËNDE?

Shuma e detyrueshme për nxjerrjen e zekatit është 2.5% nga vlera e mallrave tregtare në treg, kur kalon haulin (një vit të plotë hënor), ajo që merret në konsideratë në llogaritje është çmimi i shitjes, nëse shitja është me shumicë, atëherë merret në konsideratë çmimi i shumicës, e nëse shitja është me pakicë merret në konsideratë çmimi i pakicës.

Allahu i Madhërishëm e ka bërë farz zekatin dhe e ka bërë një prej shtyllave të Islamit. **Kushtet me të cilat detyrohet zekati për muslimanin:**

Nëse muslimani ka në pronësi pasuri që e arrin shumën për zekat dhe kjo ndryshon në bazë të llojit të pasurisë .

Kalimi i haulit¹, sipas vitit hënor.

Dispozitat e dhënies së zekatit ndryshojnë varësisht nga lloji i pasurisë.

Një: Zekati në drithëra dhe frute: Nisabi² është 5 eusuk, që është e barabartë me 610 kg përafërsisht në drithëra dhe frute, që maten dhe depozitohen siç janë: hurmat, gruri etj.

Sasia e cila duhet të nxirret zekati:

a) Nëse drithërat apo frytet ujiten me punë, siç ndodh në kopshte që ujiten nga pusët (me ujitje artificiale) duhet të nxirret gjysma e 1/10 që është e barabartë

me 5% prej drithërave dhe frutave.

b) Nëse ujitja është natyrore (prej shiut) duhet të nxirret 1/10 që është e barabartë me 10% prej drithërave dhe frutave. Koha e detyruar për nxjerrje: në të korrat dhe vjeljet.

Dy: Zekati në kartëmonedha

Nisabi: si bazë për caktimin e vlerës së zekatit të kartëmonedhave merren nisabet e arit dhe të argjendit, ngase këto të dyja janë përmendur në hadithet e zekatit, dhe duhet shikuar në vlerën (nisabin), cila është më e ulët nga këto të dyja (ari dhe argjendi), meqë në kohën tonë vlera e argjendit është më e ulët, atëherë edhe nisabi i kartëmonedhave bazohet tek argjendi, dhe siç është përmendur në hadithe nisabi i argjendit është 595 g përafërsisht, dhe kur të hollat e dikujt arrijnë vlerën e 595 g argjend

¹ Me termin HAUL kemi si qëllim të kalojë një vit i plotë hënor (354 ditë).

² Me termin NISAB kemi si qëllim shumën apo sasinë, të cilën duhet ta arrijë muslimani për të dhënë zekatin e pasurisë.

(sipas çmimit të argjendit në vendin e tij), atëherë ky është i detyruar me nxjerrjen e zekatit të atyre kartëmonedhave.

Shuma e detyrueshme për nxjerrjen e zekatit është 2.5% nga shuma e përgjithshme e parave.

Koha e detyruar për nxjerrje: Detyrohet nxjerrja e zekatit të kartëmonedhave kur të kalojë hauli, e ai është një vit i plotë sipas vitit hënor nga momenti kur i zotëron ato para. Ajo që është më e lehtë për t'u bërë nga besimtari është, se ai duhet të caktojë një ditë në vit (si p.sh një ditë nga muaji Ramazan) dhe muslimani për nxjerrjen e zekatit llogarit atë çka ka në pronësi të tij nga paratë (rrogat mujore, qiratë, xhirollogaritë etj.)

dhe në fund e zbret borxhin momental që ai ka dhe nga ajo që ka mbetur ai nxjerr 2.5% të vlerës.

Tre: Zekati i mallrave tregtare:

Çfarë kemi si qëllim me mallra tregtare? Përgjigje: Atë që ka në pronësi muslimani me qëllimin e shitjes apo të tregtisë me atë mall. Këtu nuk përfshihen mallrat, artikujt, gjësendet, pasuritë, të cilat nuk janë për shitje. Nisabi i mallit krahasohet me vlerën e vet. Sasia e tij është sikurse e kartëmonedhave. Nëse vlera e mallit është e barabartë me vlerën 595 gram prej argjendi detyrohet dhënia e zekatit.

Shuma e detyrueshme për nxjerrjen e



zekatit është 2.5% nga vlera e mallrave tregtare në treg, kur kalon haulin (një vit të plotë hënor), ajo që merret në konsideratë në llogaritje është çmimi i shitjes, nëse shitja është me shumicë, atëherë merret në konsideratë çmimi i shumicës, e nëse shitja është me pakicë merret në konsideratë çmimi i pakicës.

Katër: Zekati në aksionet e kompanive:

Pronari i aksioneve mund të jetë:

Ka si qëllim investimin dhe të marr përfitimin e të ardhurave. Nëse kompania e nxjerr zekatin për pronarin e aksionit atëherë ai nuk duhet të jap zekat përsëri (kjo vlen për tregun e Arabisë Saudite). Nëse dyshon se kompania nuk e ka dhënë të tërë zekatin, atëherë e jep vetëm atë pjesë dhe e largon barrën për veten e vet. Nëse kompania nuk e nxjerr zekatin, pronari i aksionit detyrohet të llogarisë çfarë detyrohet në vlerën e atyre që janë prezentë. Po qe se dyshon atëherë e nxjerr 2.5% prej vlerës së librit të aksioneve që ka në pronësi pas zbritjes së bazës që është stabile. Vlera e librit të aksioneve ka si qëllim të drejtat e aksionarëve të ndara në numrin e aksioneve eksportuese.

Me pronësinë e aksioneve ka si qëllim tregtimin me to, apo (azhioztazin- el-mudareben) që të përfitojë nga ndryshimi i çmimeve të blerjes dhe shitjes. Ky duhet të japi zekat nga ajo që ka në pronësi nga aksionet, duke i llogaritur ato si në rastin e zekatit të mallrave tregtare, pasi të kalojë hauli duhet të shikojë vlerën e aksioneve në treg dhe të nxjerri zekatin e mallrave tregtare 2.5%.

Pesë: Zekati i fondeve investuese

Ai që posedon përqindje të caktuara në

“...Toka është njësoj si pasuritë e tjera, ndryshon dispozita e saj varësisht nga qëllimi i pronarit të saj...”

ndonjë fond investues detyrohet të jep zekatin për to, me përjashtim nëse menaxheri i fondit e jep zekatin për të gjithë. Për fondet investuese jepet zekat, sikurse zekati i mallrave tregtare 2.5% në bazë të vlerës së saj në ditën që arrin haulin dhe minusohen ato që nuk janë për zekat nëse ka.

Gjashtë: Zekati i tokave

Toka është njësoj si pasuritë e tjera, ndryshon dispozita e saj varësisht nga qëllimi i pronarit të saj.

1) Nëse ka vendosur të bëjë me të tregti, atëherë kur ta kalojë haulin nga vlera e saj jep 2.5%, nëse ajo është në pronësinë e tij, e ka trashëguar, e ka dhuratë etj.

2) Nëse nga momenti i pronësimit të saj ai si pronar nuk ka qëllime tregtie me te, nuk jep zekat. P.sh., ka vendosur të ndërtojë një shtëpi apo kopsht.

3) Nëse toka është për ta dhënë me qira apo për të ndërtuar në te, që ai të përfitojë më pas nga qiraja, nuk ka zekat për pronarin në vlerën e saj si pronë, por zekatin e ka detyrim nga qiradhënia e saj (nga paratë e përfituara nga qiraja).

Shtatë: Zekati në aksionet në pasuri të patundshme, toka apo banesa.

Në esencë ajo që vendoset në këto kontribute prej pasurisë detyrohet me

dhënien e zekatit për çdo vit duke verifikuar fitimet. Çdo kontribuues detyrohet ta japi zekatin në bazë të vlerës së nisabit të tij. Kjo merret për konsideratë me vlerën që është e njëjtë në momentin e haulit, pa marrë parasysh shtohet nga pasuria bazë apo mangësohet .

Kontributet e dëmtuara, që nuk mund të filtrohen dhe nuk ka mundësi kontribuuesi nga ajo arritjen e pasurisë së tij, këta nuk e kanë për detyrë dhënien e zekatit nga momenti që dëmtohen.

Tetë: Zekati i borxheve

Borxhet që t'i kanë të tjerët:

Nëse nga borxhliu shpresohet që ai mund ta kthejë borxhin, për këtë rast detyrohet dhënia e zekatit në të gjitha llojet e pasurisë dhe lejohet vonimi i zekatit derisa të kthehet borxhi dhe më pas e jep për atë që ka kaluar.

Po qe se borxhliu është nga ajo kategori, që nuk pritet ta kthejë borxhin, në këtë rast nuk detyrohet dhënia e zekatit. Po qe se arrin tek borxhi i tij nga ky moment vazhdon haulin e ri e nëse e jep zekatin për një vit kjo gjë është e mirë.

Borxhet që ua ke të tjerëve:

Nëse borxhi mbetet derisa të vijë hauli i zekatit, atëherë nga tërësia e pasurisë për të cilën duhet të jepet zekat duhet të minusosh shumën e borxhit.

Nëse borxhi është me afat të vonuar, për minusimin e tij nga tërësia e pasurisë mes dijetarëve ka një mospajtim që është i njohur. Mendim më i vërtetë më duket ai që thotë se nuk duhet të minusohet. Allahu e di më së miri.

Shembull praktik për këtë që u tha:

Caktoji vetes një ditë për dhënien e zekatit, p.sh. dita e parë e Muajit Shaban. Kur të vijë kjo ditë, atëherë duhet t'i llogarisësh këto në vijim:

1. Të hollat e tua, qofshin në llogari bankare apo i ke në dorë,

2. Vlerën e tregut të asaj dite të aksioneve tua,

3. Vlerësimi i fundit për njësitë e tua në fondet investuese,

4. Arin dhe argjendin që ke në shtëpi,

5. Borxhet që i kanë njerëzit ndaj teje, nëse shpreson se do t'i kthejë,

6. Çdo mall që ke përgatitur për tregti, qoftë ajo tokë, shtëpi, kafshë apo send si dhe qoftë në shitore apo diku tjetër.

Pasi të llogarisësh shumën e gjithë këtyre, atëherë duhet të minusosh nga ajo shumë: borxhet që i ke ndaj dikujt dhe nuk i ke kthyer brenda vitit; p.sh. nëse ke blerë shtëpi me këste me çmim 100 000 euro, ti duhet të minusosh vetëm ato këste që duhej të paguheshin para përfundimit të haulit dhe ti nuk ke arritur ti paguash.

Ajo që mbetet nga e gjithë kjo është pasuria për të cilën duhet të nxirret zekat 2.5%. Gjithashtu duhet ditur se çdo pasuri mund të ketë haul të pavarur, p.sh. të hollat kanë datë në vete, mallrat e tregtisë datë në vete e kështu me radhë.

Allahu e di më së miri. Paqja dhe lavdërimet e Allahut janë mbi Muhamedin. ■

Përgatiti: Organizata Botërore Islame për Ekonomi dhe Financa 15/09/1430h.

Përktheu dhe përshtati: Rashit ZYLFIU



OBJEKTIVAT E SHERIATIT¹ NË EKONOMINË ISLAME

Njohja e objektivave të sheriatit është shumë e rëndësishme për dijetarin, myftiun, gjykatësin dhe pushtetarin, sidomos në çështjet e politikës së sheriatit, dhe në sferën e ekonomisë islame

ALI KARADAGI

Objektivat e sheriatit islam në sferën e ekonomisë mund të përmbliken në këto pika:

Realizimi i mëkëmbjes dhe i sundimit në tokë, duke e gjallëruar dhe ndërtuar atë për të mirën e njerëzimit.

Arritja e zhvillimit të plotë për njeriun dhe komunitetin në sferën ekonomike, sociale, kulturore dhe intelektuale.

¹ Për t'u njohur më gjerësisht rreth objektivat e sheriatit dhe funksionin e tyre lexoni "Objektivat e ligjit islam" nga Gëzim Selaci <http://albisلامي.com/tema/tema.asp?NrTema=203>

Ruajtja e pasurisë dhe zhvillimi i saj me investime dhe qarkullimin e saj me anë të kontratave të ndryshme, mos humbjen e saj, si dhe t'i përmbahesh një metodologjie mesatare në shpenzime pa e tepruar, por larg nga koprracia dhe dorë-shtrëngimi, sepse pasuria është shtyllë e shoqërisë. Allahu i Lartësuar në librin e tij famëlartë na thotë: ***“Mendjelehtëve (të papjekurve) mos ua jepni pasurinë, të cilën Allahu e ka bërë mjet jetese për ju...”*** (Nisa: 5).

Realizimin e misionit të pasurisë dhe pronësisë në kryerjen e rolit të tyre social dhe solidar brenda shoqërisë islame pastaj edhe komunitetit njerëzor. Pasuria është e Allahut, njeriu është məkëmbës në të, për këtë ai duhet të çojë në vend urdhrat, të cilat ia ka bërë detyrim **Pronari** i pasurisë lidhur me shpenzimin dhe solidaritetin familjar dhe shoqëror.

Disa rregulla të përgjithshme lidhur me dobitë (el-mesalih) dhe dëmet (el-mefasid):

Nëse shikojmë ajetet dhe hadithet e dispozitave, si dhe metodologjinë e të parëve tanë të mirë arrijmë në disa përfundime të rëndësishme:

Feja Islame ndalon vetëm gjërat e ndyra (el-habaith), padrejtësitë dhe dëmet, ndërsa i lejon të mirat dhe dobitë, shikoni si e ka përshkruar Allahu i Lartësuar të Dërguarin e tij (lavdërimi dhe shpëtimi i Tij qoftë me të): ***“dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj ata që do ta besojnë,***

“Pasuria është e Allahut, njeriu është məkëmbës në të, për këtë ai duhet të çojë në vend urdhrat, të cilat ia ka bërë detyrim Pronari i pasurisë lidhur me shpenzimin dhe solidaritetin familjar dhe shoqëror...”

përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit”. (Araf: 157) kjo është baza themelore mbi të cilën ndërtohen transaksionet mes njerëzve, të cilën e ka përmbledhur Lajmëtari i Allahut (lavdërimi dhe shpëtimi i Tij qoftë me të) në fjalën e tij ***“Nuk ka dëm e as të dëmtuar”.***

Në Fenë Islame kur ndahet diçka ajo sqarohet në formë të thuktë, gjë që tregon se çdo gjë përveç saj është e lejuar. Kjo është domethënia e rregullit madhështor ***“gjërat (jo adhurime) në esencë janë të lejuara”***, gjithashtu këtë rregull e mbështesin edhe disa rregulla të tjera të rëndësishme që janë ***“bindja nuk largohet me dyshim”*** dhe ***“mos ngarkesa është bazë”*** d.m.th., mos ngarkesa e detyrimeve të reja, pra për të pohuar një dispozitë nevojitet argument.

Këto rregulla tregojnë se gjërat, të cilat nuk janë të theksuara me argumente të veçanta mbesin në esencën e lejimit, dhe nuk përjashtohet nga kjo asgjë përveç atyre gjërave për të cilat veçohen me ndonjë argument të ndalesës, detyrimit, rekomandimit ose mospëlqimit, për këtë

ndikimi i parimit të dobisë (el-mesalih) në lejimin e gjërave të inovuara në gjërat jetësore (jo adhurime) vërteton këto rregulla të theksuara më lart, si dhe parimi i dëmeve (el-mefasid) ndikon në ndalimin e gjërave të reja duke u mbështetur në rregullat e përgjithshme të sheriatit, të cilat i ndalojnë dëmet dhe padrejtësitë dhe të këqijat të cilat ua tejkalojnë të mirave.

Me këtë përpikëri mund të pranohen dobitë (interesat) e papërcaktuara nga ana e sheriatit (el-mesalih el-murseleh) për t'u konsideruar si argument, përndryshe ndodh një kaos mes dy polariteteve, ku disa i neglizhojnë ato tërësisht, kurse të tjerët u japin rëndësi më shumë se sa e meritojnë, saqë i konsiderojnë si argumente të pavarura. Që të dy mendimet janë larg nga e sakta, pra interesat merren në konsideratë, me kusht që të mos bien në kundërshtim me ndonjë argument të veçantë.

Peshorja e ndikimit të dobive dhe dëmeve në lejimin apo ndalimin e zakoneve dhe transaksioneve të papërcaktuara me argumente të veçanta është si vijon:

Ajo që është tërësisht e dëmshme dhe plotësisht e ndyrë është haram i sigurt.

Ajo që është plotësisht e dobishme dhe interes i pastër është hallall gjithsesi.

Kur dëmet dhe dobitë bien ndesh, atëherë shikohet cila dominon, cila është më e fortë, më me ndikim, e kështu me radhë pra, nëse dominon dobia mbi dëmin e merr dispozitën e dobisë dhe e kundërta gjithashtu. Kjo rregull është përfituar nga Fjala e Allahut: ***“Të pyesin ty për verën dhe bixhozin. Thuaju: “Ato sjellin dëme të mëdha (gjynahe), por edhe dobi për njerëzit. Megjithatë, dëmi i tyre është më i madh se dobia”.*** (Bekare: 219), këtu Allahu i Madhëruar ka sqaruar

“Objektivat e sheriatit nuk janë argumente të pavarura (mbi të cilat mund të mbështetet legjitimimi i një dispozite pa u konsultuar me argumentet e pavarura që janë Kurani dhe Suneti) ...”

metodologjinë e legjitimit, e cila ndërtohet mbi atë që dominon dhe është më e fortë, të cilën duhet ta ndjekim në përpjekjet për të arritur të vërtetën e saktë.

Kur dëmet dhe dobitë janë të barabarta, në thelb është lejueshmëria, por ajo mund të ndalohet për shkak të rrethanave të ndryshme, efekteve anësore që mund të rrjedhin, duke u mbështetur në jurisprudencën e pasojave (fikhul me’alat), apo nga mundësia e përdorimit në gjëra të ndaluara, duke u mbështetur në jurisprudencën parandaluese (seddu dherai).

Objektivat e sheriatit nuk janë argumente të pavarura (mbi të cilat mund të mbështetet legjitimimi i një dispozite pa u konsultuar me argumentet e pavarura që janë Kurani dhe Suneti), por ato janë një peshore për ta balancuar ixhtihadin (përpjekjen për të arritur dispozitën e saktë), dhe konsiderohen si kritere për saktësinë dhe përputhshmërinë e tij me parimet e përgjithshme të Islamit, si dhe shërbejnë për t'i shfaqur bukuritë e Sheriatit, dhe për këtë duhet të kihen parasysh disa

gjëra:

Objektivat e sheriatit vijnë në pah në rastin e interesave të papërcaktuara, fikhun e pasojave dhe fikhun e parandalimit.

Njohja e objektivave të sheriatit është shumë e rëndësishme për dijetarin, myftiun, gjykatësin dhe pushtetarin, sidomos në çështjet e politikës së sheriatit, dhe në sferën e ekonomisë islame, dy fusha këto në të cilat hapësira është shumë e gjerë për një ixhtihad të futur në kornizë me rregullat e sheriatit dhe kushtet e tij, po ashtu kjo vlen edhe për lëmin e mjekësisë bashkëkohore.

Pra, njohja e objektivave është një peshore, kriter dhe masë sigurie për metodologjinë mesatare, larg nga ekstremizmi i tepruar dhe neglizhimi i moderuar.

Ixhtihadi i drejtë dhe i saktë është ai, i cili i merr në konsideratë argumentet decive integrale dhe parciaie, së bashku me objektivat e sheriatit, duke mos e sakrifikuar njërën në kurriz të tjetrës, por me një ekuilibër delikat, me një bashkëveprim mes të dyjave, ose duke i dhënë përparësi njërës nga tjetra duke u mbështetur në argumentet e qëndrueshme, duke i vendosur objektivat në rendin që e meritojnë së bashku me argumentet e sakta, pastaj kuptimi i argumenteve të pjesshme në përputhje me objektivat e përgjithshme të pranuar, e jo duke u mbështetur në objektiva dhe interesa imagjinare apo private.

Kujdesi i dijetarit dhe i myftiut për interesat e papërcaktuara (el-mesalih el-murseleh) kërkon një fleksibilitet të madh, lehtësim për njerëzit, mos mbingarkim dhe mëshirë për ta, duke u munduar të realizojë qëllimin për të cilin Allahu i Lartësuar e zbriti këtë fe, por me

një kusht që kjo (lehtësimi) të mos bide ndesh me ndonjë argument të saktë apo konsensus, apo me ndonjë parim të qëndrueshëm nga parimet islame. Kësaj rruge iu përmbajtën katër kalifët e drejtë në rregullimin e çështjeve të umetit dhe të shtetit islam.

Kjo është ajo që kërkojnë interesat e ripërtërira të umetit gjatë gjitha kohëve. Në kohën tonë kanë dalë ligje, që përcaktojnë rrogat e punëtorëve, prodhuesve, banesave. Ligje për industrinë, bujqësinë, tregtinë. Gjopa dhe ndëshkime të reja, si me rastin e përdorimit të drogës dhe tregtimit të saj. Po ashtu janë shpikur kontrata të reja të thjeshta dhe të kombinuara. Gjyqësia është ndarë në tri shkallë, pushtetet janë ndarë në tri të pavarura, si dhe shumë gjëra të reja që kanë të bëjnë me individin, shoqërinë dhe shtetin nga aspekti i brendshëm dhe i jashtëm, dhe shumë gjëra të reja, të cilat i shohim gjatë përditshmërisë.

Të gjitha këto na japin të kuptojmë, se ky sheriat është i përshtatshëm për çdo kohë dhe çdo vend. Meqë argumentet janë të numëruara dhe të kufizuara, ndërsa ndodhitë dhe shpikjet janë të panumërta, atëherë ato përpunohen në bazë të ixhtihadit të ndërtuar mbi rregullat e analogjisë, interesave të papërcaktuara, objektivave të sheriatit e të ngjashme. ■

Përktheu: Llokman HOXHA

FAMILJA, NJË INSTITUCION I RREZIKUAR

Edukimi i fëmijës me frymën islame dhe karakter të mirë është një ndër detyrat kryesore, dhe një prind i përgjegjshëm, qoftë burrë apo grua tregon më shumë interes për këtë aspekt sesa për të tjerat. Nuk mjafton që detyra e edukimit t'u lihet në dorë vetëm institucioneve arsimore, sidomos në kushtet e trojeve tona



SHKRUAN: ISMAIL BARDHOSHI

Ndërtimi i një familje të shëndetshme dhe të suksesshme është një ndër arritjet më të mira të njeriut, si për jetën e kësaj bote edhe për botën tjetër. Ajo është një ndër gjurmët më të qarta të

mëshirës, dashurisë dhe urtësisë së Zotit. Familja si struktura bazë e një shoqërie solide dhe të përsosur është po aq e lashtë sa vetë njeriu mbi faqen e tokës, pasi familja e parë mbi faqen e tokës ishte ajo e babait të njerëzisë dhe nënës së saj, Ademit dhe Havasë, si dhe e pasardhësve të tyre.

Pejgamberët e Zotit kanë jetuar në gjirin e familjes dhe kanë mishëruar e kultivuar më së miri vlerat e saj. Ata kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë për njeriun, si modeli i familjes më të lartë. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Vërtet, edhe para teje Ne dërguam Pejgamberë, të cilëve u kemi dhënë gra dhe pasardhës”***. (Rrad: 38). Familja është pikënisja dhe baza e të gjitha lidhjeve të sakta, që duhet të krijojë njeriu në një shoqëri. Ajo është e pazëvendësueshme për rolin e saj themelor dhe përcaktues në shëndetin fetar, psikik, moral, fizik dhe social të çdo individi në veçanti dhe të shoqërisë në përgjithësi. Në familje njeriu merr përfytyrimet e para mbi realitetet e besimit fetar, që ai nesër do t'i përkasë dhe mbi bindjet dhe idetë, që do të ketë në të ardhmen. Aty ai mëson ritet fetare dhe rritet me dinjitet e nder, kultivon ndjenjat e mëshirës, mirëbërjes dhe drejtësisë. Familja i kthjellon njeriut ndërgjegjen, i mëson turpin dhe ndershmërinë dhe e pajis me durim. Ajo e rrit njeriun me karakter të mirë, zgjon dhe zhvillon tek fëmija prirjet e mira, tregon kujdes të madh ndaj shtrembërimeve të karakterit, sepse shtrembërimet nisin që në vegjëli. Kështu pra familja është institucion i shenjtë, i trashëguar nga Pejgamberët; është institucion i domosdoshëm për të gjitha aspektet e jetës, por veçanërisht për edukimin e shëndetshëm të fëmijëve. Por ky institucion, të cilin e themeluan Pejgamberët në dobi të njeriut: edhe si individ, edhe si anëtar i bashkësisë ku jeton, sot është tej mase i rrezikuar. Në fakt, ne trashëguam nga brezat paraardhës një familje funksionale, të shëndetshme, të aftë për të ndikuar pozitivisht në formimin e karakterit të njeriut, por kjo trashëgimi e lavdishme mund të zhduket, nëse ne nuk do

të tregohemi vigjilentë për ruajtjen e saj. Brezat pararendës, prej të cilëve ne trashëguam edukatën familjare, ndonëse jetuan në kushte më të vështira ekonomike, bënë një jetë më dinjitoze sesa brezi ynë, sepse ishin më të ndershëm, më të mëshirshëm, më të drejtë, më besnikë, më solidarë, vlера këto të cilat ia kompensojnë njeriut çdolloj humbjeje materiale, mundimi fizik apo vuajtjeje ekonomike. Për këtë arsye ata ishin në gjendje më të mirë fetarisht, moralisht, psikikisht, madje edhe fizikisht. Sot ne përballemi me projekte që synojnë të eliminojnë institucionin e familjes dhe ndikimin e saj në formimin e karakterit të njeriut. Këto projekte, që janë në zbatim e sipër dhe që po ngrihen mbi gërmadhat e edukimit dhe formimit familjar, nxisin pareshtur tek fëmijët dhe të rinjtë e të rejat devijimin e prirjeve të natyrshme njerëzore dhe përhapjen e veseve të ulëta. Produkti i tyre është: lakuriqësia ekstreme, lidhjet e paligjshme seksuale, paturpësitë, tradhti të shumta bashkëshortore, numri në rritje i divorceve, fëmijë që rriten jashtë kujdesit familjar, femra që braktisin prindërit e tyre, fëmijë që rebelohen ndaj prindërve, gra që ngrenë krye ndaj kryefamiljarëve, pleq e plaka që jetojnë të vetmuar në moshën kur kanë nevojë për praninë e fëmijëve më shumë se kurrë; rrënimi i familjes etj. Për shtrirjen e veprimit të projekteve të tilla ngrihen slogane, që në dukje janë shumë tërheqëse, por në realitet, nëse adaptohen pa asnjëfarë kriteri, shpien në shpërbërjen e familjes, daljen e fëmijëve që në vegjëli nga kontrolli familjar dhe degenerimin e mbarë shoqërisë. Disa slogane të tilla janë: liria, barazia gjinore, të drejtat e femrës, emancipimi i femrës, të drejtat e fëmijëve, dhuna në familje etj. Këto slogane janë

shumë magjepsëse për masën e painformuar, sidomos për gratë, fëmijët dhe të rinjtë e të rejtat. Ato ngërthejnë deri në njëfarë mase gjëra të vërteta dhe të pranueshme, por pranimi i tyre pa asnjëfarë rregulli dhe pa marrë parasysh asnjë lloj kufizimi sjell në shoqëri amoralitet, anarki dhe degjenerim të përmasave jashtëzakonisht të frikshme. I ndodhur në kushte të tilla dhe në mes të një ambienti të tillë muslimani e ka seriozisht të vështirë të krijojë një familje të shëndetshme dhe të edukojë fëmijët në gjirin e saj. Rritja e fëmijës me formim islam, devocion fetar dhe karakter të shëndetshëm është pa dyshim, një ndër shqetësimet kryesore, që kanë muslimanët e viseve tona. Nuk janë të pakta rastet e familjeve, të cilave u ka rënë një ndër sprovat më të rënda: largimi i fëmijëve ose devijimi i tyre. Edukimi i fëmijëve është një përgjegjësi që Allahu ua ka ngarkuar prindërve, një detyrë kjo për të cilën do të japim llogari në Ditën e Gjykimit. Allahu thotë në Kuran: ***“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët”***. (Tahrim: 6). Ky ajet ngarkon me përgjegjësi burrin, i cili ka në dorë frenat e drejtimit të familjes, që të ruajë bashkëshorten dhe fëmijët nga zjarri, duke u mësuar atyre besimin e pastër islam, dashurinë për Zotin, frikën prej dënimit të Tij, ibadetet, karakterin e shëndoshë etj. Ajeti bën thirrje që njeriu, pikë së pari, të ruajë vetveten nga zjarri e pastaj, të kujdeset për familjen. Nga kjo kuptohet mjaft qartë se kryefamiljari duhet të bëhet shembull për të gjithë anëtarët e familjes. Për rrjedhim, nëse kryefamiljari nuk bëhet shembull për familjen në ibadet, devocion, moral, sjellje dhe disiplinë ai nuk mund të edukojë familjen për t'u ruajtur nga zjarri i

“...Rritja e fëmijës me formim islam, devocion fetar dhe karakter të shëndetshëm është pa dyshim, një ndër shqetësimet kryesore, që kanë muslimanët e viseve tona...”

Xhehenemit. Ajeti i mësipërm ngarkon me përgjegjësi edhe gruan, pasi edhe ajo duhet të shoqëroje burrin në mbarëvajtjen e familjes, në ruajtjen e moralit të saj dhe në edukimin e fëmijës. Gruaja ruan moralin e familjes, kultivon tek fëmijët ndjenjat e dhembshurisë, dashurisë dhe mirëbërjes. Nëse ajo ruan moralin, familja do të jetë e moralshme, e nëse ajo e tradhton moralin, familja rrezikon të humbë moralin. Ajo ndjek vazhdimisht ecurinë e zhvillimit të fëmijës në çdo hap dhe këqyr me kujdes të madh moralin dhe karakterin e tyre. Ibën Omeri thotë: “Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut duke thënë: ***Të gjithë jeni roje dhe përgjegjës për atë që keni nën kujdestari. Kështu, prijësi është kujdestar dhe ai është përgjegjës për ata që i ka në varësinë e tij; burri është kujdestar për familjen e tij dhe ai është përgjegjës për ata që ka në varësinë e tij; gruaja është kujdestare në shtëpinë e burrit të saj dhe ajo është përgjegjëse për atë që ka nën kujdestarinë e saj; shërbëtori është kujdestar në pasurinë e pronarit të vet dhe ai është përgjegjës për atë që ka nën kujdestari. Pra, të gjithë jeni kujdestarë dhe të gjithë jeni përgjegjës për atë që keni në varësi.”*** Shënojnë Buhariu dhe Muslimi. Hadithi dëshmon se njerëzit do të pyeten në Ahiret për përgjegjësinë që u ka ngarkuar

Allahu. Prandaj, nëse kujdestari e ka përmbushur detyrën, do të marrë shpërblim, në të kundërt, çdo vartës do t'i kërkojë të drejtën që nuk ia ka plotësuar, ose që ia ka lënë pas dore. Më tej, theksohet fakti se burri është përgjegjës për pjesëtarët e tjerë të familjes, që do të thotë se ai do të pyetet në Ditën e Gjykimit për plotësimin e të drejtave të tyre, ku me siguri ndër të tjera përfshihet dhe edukimi i tyre me frymën, moralin dhe karakterin islam. Në vazhdim, hadithi ngarkon mjaft qartë me përgjegjësi edhe gruan për rregullimin e shtëpisë, këqyrjen e pasurisë së burrit, edukimin e fëmijëve, detyra këto për të cilat do të pyetet në Ditën e Llogarisë. Në një hadith tjetër Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *“Sigurisht që Allahu do ta pyesë çdo kujdestar për atë që ia ka lënë nën ruajtje, nëse e ka ruajtur apo e ka lënë pas dore, aq sa edhe burrin do ta pyesë për njerëzit e shtëpisë”*. Shënon Ibën Hibani. Është për t'u vlerësuar interesimi i prindërve në përgjithësi për t'u plotësuar nevojat fëmijëve, për të mbuluar shpenzimet e tyre, për trajtim mjekësor etj., pasi kjo është një pjesë e përgjegjësisë, që ua ka ngarkuar Allahu, por a mbaron përgjegjësia me kaq? Edukimi i fëmijës me frymën islame dhe karakter të mirë është një ndër detyrat kryesore, dhe një prind i përgjegjshëm, qoftë burrë apo grua tregon më shumë interes për këtë aspekt sesa për të tjerat. Nuk mjafton që detyra e edukimit t'u lihet në dorë vetëm institucioneve arsimore, sidomos në kushtet e trojeve tona, sepse së pari, çdo teori që shmang familjen në formimin dhe edukimin e fëmijës është e dëmshme, dhe së dyti, përmbajtja e teksteve mësimore të institucioneve tona është shpeshherë e dëmshme. Për me tepër që edhe mësuesit kanë shumë mangësi, dhe

“...Kryefamiljari nuk bëhet shembull për familjen në ibadet, devocion, moral, sjellje dhe disiplinë ai nuk mund të edukojë familjen për t'u ruajtur nga zjarri i Xhehenemit...”

mbase edhe deviacione në besim dhe në karakter. Ç'është akoma më e keqe, shoqëria që rrethon fëmijën në shkollë kryesisht është e dëmshme. Në kushte të tilla prindi e ka detyrë të sigurojë për fëmijët, nëse dëshiron t'i arsimojë ambiente arsimore të shëndetshme, ku nuk merr devijime në besim apo në karakter. Më problematike në këtë këndvështrim paraqitet mosha e adoleshencës dhe e rinisë së fëmijës. Në një moshë të tillë assesi nuk mund t'i lejohet prindit, që ta dorëzojë fëmijën në ambiente shkollore të pasigurta, të pashëndetshme. Nëse ndonjërit nuk i duken bindëse këshillat që japin dijetarët e fesë Islame, të paktën le të marrë mend nga sprovat, që po vuajnë shumë familje, si pasojë e dërgimit të fëmijëve në ambiente të tilla. Po këtu gjej rastin t'u bëj thirrje të gjithë atyre që u dhimbsen fëmijët e muslimanëve dhe e ardhmja e Islamit në këtë vend, që të lëvizin për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi, duke hapur institucione arsimore të rregullta, ose duke kontribuar në përmirësimin e shkollave ekzistuese.

Më poshtë po përmend disa udhëzime për prindërit, të cilat do t'i ndihmojnë ata në edukimin e fëmijëve:

T'u diktosh fëmijëve të vegjël rregullisht

shehadetin, suret, dhikret dhe lutjet e namazit, si dhe dhikrin e mëngjesit dhe të mbrëmjes.

Të zgjedhësh shoqëri të mirë për fëmijën, sidomos kur prindi është shumë i zënë me punë, me qëllim që shoqëria të mos i prishë besimin dhe karakterin.

Të falësh Sunetet dhe namaz nafile në shtëpi, si një metodë praktike në edukimin e fëmijës dhe në dhënien e shembullit të mirë për të.

T'u mësosh fëmijëve rregullat e mikpritjes dhe vizitës së të tjerëve në praktikë.

Të sigurosh një bibliotekë familjare me libra, kaseta dhe disqe të dobishme e të larmishme.

Të mos lejosh në asnjë mënyrë që fëmijët të ndjekin filma vizatimorë apo programe televizive në stacionet aktuale në gjuhën shqipe, pasi janë me të vërtetë helm për sjelljen dhe formimin e fëmijës. Por prindi e ka të vështirë të ndalojë fëmijët nga ndjekja e stacioneve të tilla, nëse i ndjek vetë, prandaj prindi duhet të heqë dorë vetë një herë e mirë nga ndjekja e stacioneve të tilla. Gabohet ai që mendon se stacione të tillë janë të nevojshme për të marrë informacion apo njohuri të reja, pasi nëse ato kanë ndopak dobi, dëmi i tyre është shumë më i madh, përveç që informacionet që jepen nëpërmjet tyre mund të merren përmes mjeteve të tjera, të cilat sot janë të shumta.

T'i dërgosh fëmijët për nxënien e Kuranit përmendësh në xhami, dhe të tregosh interes për mësimin e tij përmendësh më shumë sesa për mësimet e tij të përditshme

“...Është provuar se mësimi i Kuranit përmendësh, jo vetëm që nuk ndikon në mësimet e tjera të fëmijës, por e ndihmon të përparojë...”

në shkollë. Nëse në ndonjë vend nuk ka mejtep për mësimin e Kuranit përmendësh, ai duhet të krijohet medoemos, sepse është një ndër format kryesore për ruajtjen e fesë tek brezi i ardhshëm. Është provuar se mësimi i Kuranit përmendësh, jo vetëm që nuk ndikon në mësimet e tjera të fëmijës, por e ndihmon të përparojë.

T'u mësosh fëmijëve çdo ditë nga një çështje fetare ose t'u tregosh ndonjë rrëfim të dobishëm.

Të dërgosh njërin nga fëmijët që të bëhet dijetar musliman për udhëheqjen e pjesëtarëve të tjerë të familjes. Këto janë masa të domosdoshme për të ruajtur fenë e pasardhësve.

Të ndjekësh mësimet fetare bashkë me fëmijët në xhami apo diku tjetër.

T'i mësosh fëmijës mbajtjen e besës, vërtetësinë, trimërinë, turpin, bujarinë, altruizmin etj. virtyte të mira.

Të ruash fëmijën nga gënjeshtria, pabesia, mashtrimi, frika, koprracia dhe paturpësitë.■

KUR HESHTJA NUK ËSHTË FLORI

Burri dhe gruaja e trajtojnë konfliktin ndryshe. Ndërsa shumica e burrave zemërohen dhe dalin stuhishëm nga shtëpia, bërtasin ose ngrenë zërin, ose akoma më keq heqin dorë fare, gratë prirën të ndalen dhe të heshtin

NASIHA AHMAD

Kur dikush thotë diçka që ka të bëjë me ne, na është thënë se duhet “ta kthejmë faqen në anën tjetër”. Kur jemi të zemëruar dhe digjemi për t’i thënë dikujt diçka, na është thënë se në qoftë se nuk kemi diçka të mirë për t’i thënë, nuk

duhet t’i themi asgjë. Jemi mësuar që t’i kafshojmë buzët dhe ta ruajmë gjuhën sa herë që ndjejmë se do të shpërthejmë nga zemërimi dhe sa herë që shkumëzojmë nga hidhërimi; heshtja është më e mirë se sa sharja apo sulmi. Jemi mësuar që në moshë të re, se heshtja është flori.

Por ja, vjen një kohë kur heshtja mund



të të djegë më shumë, se sa fjalët më të këqija, ose të plagos më tepër se sa thikat më të mprehta. Kur heshtja është e mbushur me tërbim dhe e ruajtur gjatë me mëri, kjo heshtje është vdekjepurëse. Dhe për fat të keq shumë femra e njohin shumë mirë këtë “trajtim me heshtje”. Pa dyshim shumë femra e kanë përjetuar këtë trajtim me heshtje nga të dy përfundimet – atë të dhënies dhe atë të pranimit.

Sjellja me heshtje thjesht do të thotë: maturi ndaj të folurit, por ajo ndonjëherë është e shoqëruar nga një frymë e ftohtë, qëllimkeqe apo indiferente, që lind jo thjesht prej mungesës së fjalëve, por gjithashtu edhe synon të neglizhojë ose lëndojë.

Heshtja ndërmjet bashkëshortëve

Burri dhe gruaja e trajtojnë konfliktin ndryshe. Ndërsa shumica e burrave zemërohen dhe dalin stuhishëm nga shtëpia, bërtasin ose ngrenë zërin, ose akoma më keq heqin dorë fare, gratë priren të ndalen dhe të heshtin. Shumica e tyre mbështeten në trajtimin me heshtje. Kur gjërat nuk shkojnë në atë mënyrë që një grua i dëshiron ajo mund të vendosë, që në vend të grindjes me burrin e saj zgjedh që ta shmangë atë, injorohet dhe mos të flasë më për të. Ajo i jep atij supën e ftohtë, nuk e shikon, ndërsa në anën tjetër ruan rendin në shtëpi, kujdeset për fëmijët, gatuan ushqim etj. Po si është e mundur kjo? Oh, kjo është e mundur dhe mjaft e mundshme në shumë familje.

Dikush një herë më dha disa këshilla paramartesorë: “As mos të kesh ndonjë pritje bile”. Ajo çfarë thoshte ishte se: në qoftë se kemi shpresa dhe ato nuk realizohen do të jemi të pakënaqura dhe të mërzitura. Pastaj në një mënyrë apo tjetër ne nuk do të na zë vendi-vend. Shumica e

grave nuk “sulmojnë” me fjalë, ato tërhiqen dhe “presin” që personi tjetër duhet thjesht të dijë se cili është gabimi.

Merrni për shembull rutinën e një përvjetori martese. Gruaja mund të “presë” diçka të veçantë, por burri i saj mund të jetë pragmatik dhe i dhuron asaj diçka praktike, ose akoma më keq, asgjë fare. Tani ajo nuk flet me të. Ai nuk e kupton pse. Shumica e grave që e njohin këtë e dinë saktësisht, se çfarë ndjen ajo dhe shumë nga ju që jeni duke e lexuar këtë mundet edhe ta keni përjetuar të njëjtën gjë.

Problemi lind kur ngjarjet si ajo më lart ndodhin dhe ne mbyllemi e nuk flasim. Ne zemërohemi dhe në vend që të sqarohemi, ose të kërkojmë një shpjegim ne varim buzët dhe presim që burrat tanë duhet ta kenë ditur më mirë. Por ky trajtim me heshtje është helmues në një martesë. Është si një ajsberg në mes burrit dhe gruas; ajo krijon çarje në mes tyre, ashtu që edhe nëse koha e ndreq atë do të lindi një çarje tjetër dhe tjetra duket edhe më e madhe dhe më e gjerë se sa e para. Sepse ajo merr shprehinë e trajtimit të heshtjes, ku kjo bëhet armë më e lehtë dhe më e rëndomtë për t’u zgjedhur. Dhe është kjo armë që ajo do të përdorë në të gjitha sjelljet e tjera, gjithashtu edhe me të afërmit e tjerë të saj.

Heshtja keqdashëse në mes motrave

Gratë janë të njohura të kenë aftësinë për të përmirësuar lidhjet në mes njëra-tjetrës. Ato mund të jenë mike më të dashura, duke ruajtur miqësinë e përhershme, e cila qëndron e fortë në vitet e lumturisë dhe të lotëve. Por gjatë atyre kohëve disa nga këto miqësi po hasin në ndarje. Ndryshe nga ndarjet e tjera, të cilat mund të rezultojnë nga grindje me fjalë

“Por ky trajtim me heshtje është helmues në një martesë. Është si një ajsberg në mes burrit dhe gruas; ajo krijon çarje në mes tyre...”

dhe zënka, shumë prishje në marrëdhëniet e femrave të rritura përfundojnë për shkak të trajtimit të thjeshtë, por domethënës të heshtjes. Kjo mungesë e të folurit ka një gjerësi, që flet më shumë se sa fjalët. Një grua e di, se të neglizhohet, ose të injorohet nga një mike është më e rëndë, se sa një betejë e fjalëve.

Kujtoje një kohë për shembull, kur ke qenë në shkollë (shkollë të mesme apo fakultet) dhe papritmas disa nga mikeshat e tua vendosin, se ato nuk duan më të jenë mikeshat e tua. Ato fillojnë të të injorojnë dhe mos të të kushtojnë vëmendje në çdo gjë që thua. Ajo çka thua dhe ajo çka ke bërë nuk bën ndonjë dallim; ato nuk brengosen më për ty dhe ti nuk e di pse. Ndoshta kjo ishte sepse ti i ofrove ndihmë një shoqeje me detyrat e saj të shtëpisë e jo tjetrës, ose ndoshta e ftove një shoqe para një nate, e jo të tjerat. Kjo mund të jetë çdo gjë, ose në të vërtetë asgjë. Arsyeja është e parëndësishme, por pasojat janë astronomike. Çështja është se rezultati që rrjedh nga heshtja është i dëmshëm për të gjithë të përfshirët në një çështje.

Thikë me dy tehe

Trajtimi i heshtjes është një thikë me dy tehe: ai që qëndron i heshtur dhe ai që e pëson heshtjen, të dy vuajnë. Është e qartë, se njëra palë, e cila pëson heshtjen “ndëshkohet”, ajo është e shmangur, e

injuar, e lënë pas dore dhe e neglizhuar. Ky person bëhet dhe objekt në mënyrë ironike; është njësoj sikur ajo të mos ekzistonte më. Ajo është bërë të ndihet e padukshme dhe ndoshta e pavlerë, e aq më pak e padenjë për të qenë shoqe me personin tjetër në fjalë. Nga ana tjetër e thikës pala që jep ndëshkimin vuan (edhe nëse ajo nuk e kupton në kohë), sepse të trajtosh dikë me heshtje do të kërkonte një këmbëngulje, përkushtim dhe qëndrueshmëri në një farë mënyre keqdashje dhe hakmarrje – asgjë nga e cila mund të rezultojë diçka e vlefshme. Ky lloj trajtimi me heshtje do t’ia thithte energjinë emocionale personit; duke vepruar kështu, do të thotë që dikush që merakosej për këtë vetëm disa ditë më parë në një farë mënyre mësohet me këtë. Edhe pse ndoshta mund ta bindim veten, se nuk mërzitemi në thellësinë e zemrës tonë, edhe ne (që nisim apo nxitim heshtjen) do të duhet ta pranojmë humbjen e kësaj miqësie, të cilën po e shmangim.

Me fjalë të tjera merr shumë mund dhe përpjekje për të injoruar dikë aq me këmbëngulje; dhe nuk është e lehtë të lëndohet dikush aq thellë pa thënë një fjalë apo të çosh dorën. Përpjekja më e madhe duhet të ushtrohet, se duhet të sigurohemi që pala tjetër ta dijë, se jemi duke e injoruar atë dhe jemi duke iu shmangur.

Rreziku qëndron në atë se sa gjatë ne do të mundet ta vazhdojmë këtë mëri që ndez heshtjen tonë. Nëse mësohemi të jemi të heshtur dhe të injorojmë një mikeshë të veçantë, apo një mikeshë të caktuar për gjatë një kohe të mjaftueshme, ajo mike nuk do të mbetet më mike dhe zyrtarisht mund të themi se e kemi humbur atë. Këtu qëndron porosia jonë. Islami në fakt jep një afat tre-ditor pas së cilës zemërimi

duhet të largohet. Pastaj dy njerëzit e larguar duhet të përshëndesin njëri-tjetrin përsëri. *“Nuk i lejohet muslimanit ta bojkotojë vëllanë e tij musliman më tepër se tre ditë. Ndoshta takohen ose përballen me njëri-tjetrin dhe nëse njëri kthen shpinën po ashtu edhe tjetri e kthen shpinën. Më i miri prej tyre është ai që e fillon me selam”.*

Sipas hadithit të mësipërm, nëse të dy palët janë në konflikt me trajtimin e heshtjes vetëm njëra palë e ka në dorë zgjidhjen ndaj tjetrës. Në të tilla raste zgjidhja është e mundur të bëhet ashtu që; ose ai që po injorohet duhet të mundohet të ndryshojë me gruan, e cila është e zemëruar dhe të përpiqet ta bëjë të flasë, dhe të kuptojë se ku qëndron saktësisht gabimi, ose ai që është i heshtur duhet më në fund të flasë dhe të pajtohet me miken e vet para se të jetë tepër vonë...

I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: *“Kushdo që e braktis vëllanë e tij për një vit është njësoj sikur ta kishte derdhur gjakun e tij.”* (Buhariu). A mund të imagjinoni sikur kjo të ndodhte në jetën tonë? Sigurisht në qoftë se një kohë e mjaftueshme ka kaluar dhe ne nuk kemi folur me dikë për një kohë mjaft të gjatë, mundet lehtë që një vit të shkojë pa u vërejtur. Në fakt është shumë e lehtë.

Nëse dikush ka filluar të sillet me heshtje ndaj teje, në fillim ju ndoshta do të përpiqeni të kuptoni se pse, por në qoftë se kjo gjë nuk ju sjell dobi, atëherë ndoshta do të hiqni dorë nga përpjekja dhe thjesht mendoni: *“Ou mirë, nëse ajo nuk dëshiron të flasë me mua, ose të jetë shoqja ime, lëre fare, harroje”.* Ju atëherë me të vërtetë do ta harroni atë, siç ka mundur ta bëjë vetë ajo. Por kjo me sa duket mund të jetë një miqësi e humbur për një arsye fare të parëndësishme, dhe

“...Në vend që të sillesh me heshtje, ose të lejosh dikush të ta bëjë atë, identifikoje dhe pastaj zgjidhe problemin në vend të përjetimit të tij. Bisedoji gjërat direkt...”

me një pasojë të fortë të mundshme, duke pasur parasysh hadithin e mësipërm.

ZGJIDHJA

Gjej një zgjidhje! Në vend që të sillesh me heshtje, ose të lejosh dikush të ta bëjë atë, identifikoje dhe pastaj zgjidhe problemin në vend të përjetimit të tij. Bisedoji gjërat direkt, derisa të vini deri te një lloj zgjidhje, kompromis ose marrëveshje.

Nëse nuk doni të flisni asnjëherë, të paktën përpiqu të bëhesh “njeri i madh” dhe thuaja ti selamin i pari.

Mos e fillo ti. Shmangeni heshtjen ndaj kujtdo qoftë të niset nga ju. Për disa është e vështirë ta bëjnë këtë, por mundohu t'i largohesh të heshturës më mirë se të flasin çfarë ka në kokën tënde, dhe në vend që të mbyllësh dikë nga jeta jote.

Nëse e parandalojmë çdo problem para se ai të rritet e të bëhet i madh, duke folur direkt, ne mund t'i largohemi atij problemi pa pasur nevojë të sillemi ndaj dikujt me heshtje. ■

Përktheu nga anglishtja: Drita N. Maliqi



SPROVA E FEMRAVE

“Dynjaja është e bukur dhe e gjelbër. Allahu do t’ju vendosë mëkëmbës në të dhe do të shohë sesi do të punoni. Prandaj kijani frikën dynjasë dhe kijani frikën grave, sepse sprova e parë për Beni Israilët ishte tek gratë.”

DR. EMIN BIN ABDULLAH ESH-SHEKAVI

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, i Vetëm dhe i Pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij.

Një nga sprovat e mëdha me të cilat përballlet muslimani sot në këtë jetë është sprova e femrave. Me këtë sprovë ai përballlet në treg, në rrugë, në vendet publike, në gazeta, revista dhe në media. Allahu i Lartësuar thotë:

“Burrave u është hijeshuar dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara. Këto janë kënaqësitë e kësaj jete, por shumë më i mirë është kthimi tek Allahu” (Ali Imran; 14).

I Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* i ka tërhequr vëmendjen umetit të tij nga sprova e femrave. Buhariu dhe Muslimi përcjellin një hadith nga Ebu Seid Hudriu *radijallahu anhu*, që thotë se i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka thënë: *“Nuk kam lënë pas meje sprovë tjetër më të dëmshme për burrat se sa gratë.”*¹

I Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka njoftuar se sprova e parë me të cilën janë përballur Beni Israilët ka qenë gratë. Imam Muslimi shënon në Sahihun e tij hadithin e përcjellë nga Ebu Seid Huderiu, se i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka thënë: *“Dyngja është e bukur dhe e gjelbër. Allahu do t’ju vendosë mëkëmbës në të dhe do të shohë sesi do të punoni. Prandaj kijani frikën dynjasë dhe kijani frikën grave, sepse sprova e parë për Beni Israilët ishte tek gratë.”*²

I Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka njoftuar se ai që bën durim ndaj kësaj sprove do të bëjë pjesë ndër shtatë njerëzit, që Allahu do t’i mbulojë me hijen e Tij. Buhariu dhe Muslimi përcjellin nga Ebu Hurejre, se i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka thënë: *“Shtatë (vetë) Allahu do t’i mbulojë me hijen e Tij atë ditë, kur nuk do të ketë hije tjetër përveç hijes së Tij”*. Ndër ta përmendi: *“Një burrë që e kërkoi një grua me pozitë dhe bukur*

“...Kjo është një çështje me të cilën nëse njeriu sprovohet me të, nuk i dihet se si përfundon çështja e tij...”

*dhe ai iu përgjigj: “Unë kam frikë Allahun.”*³

Kadi Ajadi thotë: “Gruaja me pozitë dhe bukuria është përmendur në mënyrë të veçantë, sepse ajo kërkohet shumë dhe është e vështirë që të mbërrish tek ajo, sidomos kur i ka të dyja; edhe postin, edhe bukurinë, madje kur bëhet fjalë që ajo vetë e kërkon diçka të tillë. Në këtë mënyrë ajo i ka kursyer burrit kohën për të kontaktuar me të dhe lidhjen pas saj. Kështu, bërja durim për shkak të frikës ndaj Allahut të Lartësuar, ndërkohë që ajo vetë ka kërkuar prej tij, që t’ia japë këtë mundësi, duke i pasur të dyja; postin dhe bukurinë, përbën një nga gradët më të larta dhe një nga adhurimet më të mëdha. Si shpërblim Allahu i Lartësuar ka vendosur që ta mbulojë me hijen e Tij. Një grua me pozitë do të thotë një grua që ka prejardhje fisnike.»⁴ Në lidhje me një njeri të tillë dhe të tjerë si ai Allahu i Lartësuar thotë: **“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”** (Naziat; 40, 41).

Shembulli i këtij njeriu që bën durim ndaj sprovës së femrave është Profeti fisnik, i biri i një fisniku, e ky biri i një fisniku ishte Jusufi, i biri i Jakubit, i biri i Is’hakut, i biri i Ibrahimit, paqja e Allahut

1 - Buhariu 5096 dhe Muslimi 2740.

2 - Muslimi 2742.

3 - Buhariu 1423 dhe Muslimi 1031.

4 - Komentet e Sahihul Muslimin nga Neveviu 3/122.

goftë mbi ta. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Por ajo, në shtëpinë e së cilës gjendej ai nisi ta joshë në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert dhe tha: “Jam e gatshme për ty!” Kurse ai tha: “Allahu më ruajt! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe pa dyshim keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë.”*** (Jusuf; 23). Përkundrazi Jusufi *alejhi salatu ue selam* parapëlqeu burgun në vend që t'i gjunjëzohej kësaj sprove. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Ai tha: “O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt tyre dhe do të bëhem nga ata që nuk i dinë (ligjet e Tua).”*** (Jusuf; 33).

Ibën Kajimi thotë: “Allahu i Lartësuar ka paraqitur ndershmerinë e lartë të Jusufit *alejhi salatu ue selam*, sepse shtysat me të cilat u përball nuk i kishin ndodhur askujt para tij. Ai ishte i ri dhe i riu ka epshe dhe dëshira të ndërthurura. Ai ishte beqar dhe nuk kishte se si ta shfrynte këtë gjendje, ishte i panjohur dhe larg familjes dhe vendit të tij. Njeriu që jeton me familjen dhe shokët e tij ka turp prej tyre, se mos kuptojnë diçka prej tij, por nëse je i huaj kjo pengesë nuk ekziston. Ai ishte në pozitën e një skllavi dhe skllavi nuk e përçmon atë që e përçmojnë njerëzit e lirë. Ajo ishte një grua e bukur dhe me pozitë, kështu që shtysa për t'u afruar me të ishte më e madhe, se me një grua që nuk është e tillë. Ndërkohë ishte ajo që po e kërkonte një gjë të tillë dhe në këtë mënyrë eliminohej mundimi i burrit për të kërkuar dhe frika e tij nga mungesa e përgjigjes. Bashkë me kërkesën ajo shtoi edhe dëshirën e saj të plotë dhe joshjen përmes së cilës mund të largohej prej Jusufit *alejhi selam* çdo provim dhe sprovë për të

kuptuar ndershmerinë nga pandershmeria e tij. Ajo ishte në vendin e pushtetit dhe në shtëpinë e saj. Kjo i jepte asaj mundësinë për të gjetur vendin e duhur dhe pozicionin që nuk kapej nga sytë e njerëzve. Pavarësisht kësaj ajo i mbylli edhe dyert, në mënyrë që të sigurohej nga çdo hyrje e papritur dhe shkoi tek Jusufi me hir dhe pa pahir. Por me gjithë këtë Allahu e ruajti Jusufin dhe ai nuk iu bind asaj, i dha përparësi të drejtës së Allahut dhe të drejtës së burrit të saj përpara gjithë kësaj që i ofronte ajo grua lirisht. Kjo është një çështje me të cilën nëse njeriu sprovohet me të, nuk i dihet se si përfundon çështja e tij.”⁵

Poeti thotë:

Katër sjellje më ndalojnë nga paturpësitë,

Prej të cilave njeriu fisnik së tepërmi ruhet,

Më ruan turpi, Islami, thinjat dhe morali,

Sepse njeriu shkon pas asaj që i do shpirti.

Durimi ndaj këtyre sprovave dhe parapëlqimi i kënaqësisë së Allahut para dëshirave të vetvetes është një nga veprat më të mira përmes së cilave njeriu afrohet tek Zoti i tij. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Kurse ai që i është frikësuar madhërisë së Zotit të tij dhe e ka frenuar veten nga dëshirat, pa dyshim që do të ketë për strehë Xhenetin.”*** (Naziat; 40, 41).

Dy imamët, Buhariu dhe Muslimi na përcjellin një hadith nga Ibën Omeri se i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka thënë: ***“Teksa po ecnin tre burra i zuri një shi dhe u strehuan në një shpellë në një mal. Papritur hyrja e shpellës u zu nga një shkëmb, që ra nga mali dhe ua mbylli hyrjen. Ata iu drejtuan njëri-tjetrit:***

5 - “Bedaiu et-tefsir” 2/445, 446.

"Shikojini veprat e mira që keni bërë për Allahun dhe lutuni Allahut, se ndoshta na largon shkëmbin. Njëri prej tyre tha: "O Allah! Kam pasur një vajzë xhaxhai, të cilën e kam dashur aq shumë sa mund të dojë një burrë një grua dhe i kërkoja që të më afrohej, por ajo refuzoi vetëm nëse i jepja njëqind dinarë. U lodha shumë derisa i mblodha njëqind dinarë dhe pastaj shkova tek ajo. Kur rashë mbi këmbët e saj ajo më tha: "O rob i Zotit! Kije frikë Allahun dhe mos e vendos unazën (mos bëj marrëdhënie të ndaluara) veçse me të drejtë (me martesë). Unë u largova prej saj dhe Ti e di fare mirë, se këtë e kam bërë vetëm për hatër të Fytyrës Tënde, prandaj largoje paksa shkëmbin dhe shkëmbi u largua pak." ⁶ Hadithi vazhdon.

Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar besimtarët që nuk kanë mundësi të martohen që të bëjnë durim dhe të ruajnë nderin. Allahu i Lartësuar thotë: **"Ata që nuk kanë mundësi për martesë, le ta përmbajnë veten, derisa Allahu t'i begatojë me mirësinë e Tij."**⁷ (Nur; 33).

Një nga mënyra e largimit prej sprovës së grave është mbulimi i shikimit, ruajtja e organeve dhe martesa e lejuar. Allahu i Lartësuar thotë: **"Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre** (nga e ndaluara) **dhe ta ruajnë nderin e tyre** (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) **! Kjo është më e mirë për ta! Me të vërtetë Allahu është i Dijshëm për atë që bëjnë ata."** (Nur; 30).

Buhariu dhe Muslimi përcjellin një hadith nga Ibën Mesudi, se i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka thënë: *"O ju të rinj! Kush prej jush ka mundësi le të martohet, sepse ajo (martesa) jua mbron më shumë shikimin dhe jua ruan më shumë*

“...I Dërguari i Allahut alejhi salatu ue selam ka bërë me dije se Xheneti është shpërblimi i atij që ruan organet e tij nga harami...”

organet.”⁸

Poeti thotë:

*Nga shikimi shkaraz fillon çdo telash,
Nga shkëndijë e vogël ndizet zjarr i madh,*

Sa shikime prej syve në zemër depërtuan,

*Si shigjetë prej harkut tej e tej e shpuan,
Për aq kohë sa rob i vështirime bredh,
Mbi rrezik hedh hapin e rreziqe mbledh,
Shpirtin ta plagos, ajo syrin ta kënaq,
Larg qofsh o gëzim që prish rend e paqë.*

I Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka bërë me dije se Xheneti është shpërblimi i atij që ruan organet e tij nga harami. Buhariu përcjell në Sahihun e tij një hadith nga Sehël ibën Sadi, se i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka thënë: *"Kush më garanton atë që ka mes nofullave dhe atë që ka mes kofshëve unë i garantoj atij Xhenetin."* Së fundmi, falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe mëshira e tij qofshin mbi profetin tonë Muhamedin, mbi të gjithë shokët e ndjekësit e tij. ■

Përktheu: Genc PLUMBI

6 - Buhariu 2215 dhe Muslimi 2743.

7 - En-Nur; 33.

8 - Buhariu 5066 dhe Muslimi 1400.

9 - Buhariu 6474.

SPROVAT E DYNJASË DHE SHPËRBLIMI I ALLAHUT

Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“S’ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, ndërsa ajo që është tek Allahu, është shpërblim i madh.”***

Tegabun 15.

SHKRUAN: ALI SHABANI

Ky ajet kuranor është nga sureja Tegabun, e cila ka zbritur në Mekë. Ata ibën Jesari *radijallahu anhu*, ka thënë se sureja Tegabun ka zbritur e tëra në Meke, përveç këtij ajeti, i cili ka zbritur në Medinë në lidhje me Auf ibën Malik El-Eshxhain, që kishte familje të madhe. Ai kur u nis të dilte në luftë anëtarët e familjes së tij kanë qarë, e kanë bërë t’i dhimbsen. Ata i thoshin: Ku po na len? Kështu atij i dhimbseshin dhe qëndronte me ata, pastaj ka zbritur ajeti: ***“S’ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë,...”***. Nga thënia e Ata ibën Jesarit duket qartë, se ajeti ka zbritur në Medinë meqë përmendet lufta, sepse në periudhën mekase nuk ka pasur luftë. Është përmendur nga Ikrimja *radijallahu anhu*, se ky ajet ka zbritur në lidhje me disa persona, të cilët deshën t’i bashkëngjiten Islamit e të bëjnë hixhret, mirëpo gratë dhe fëmijët e tyre i ndalën.

Ikrimja tregon se një njeri e ka pyetur Ibën Abasin *radijallahu anhu*, për këtë ajet



dhe ai ka thënë: këta kanë qenë disa burra të cilët kishin pranuar islamin dhe deshën të vinë te Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*, por gratë dhe fëmijët e tyre nuk pranuan t'i lënë vetë. Mirëpo kur shkuan te I dërguari i Allahut *sal-lallahu alejhi ue selem* më pas, vërejtën se njerëzit tjerë kishin mësuar shumë nga feja, ata deshën që t'i ndëshkojnë anëtarët e familjes së tyre dhe zbriti ajeti: ***“S’ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë...”***

Nga Ikrimeja përcillet edhe me version tjetër, ku ata kanë thënë pasi i kanë takuar shokët e tyre që kishin bërë hixhret, dhe pasi kishin mësuar shumë nga feja, se do t'i ndëshkojnë anëtarët e familjes që ndaluan nga kjo. Pastaj ka zbritur ajeti: ***“...e nëse nuk merrni masa, nuk ua vini veshin dhe i falni, ta dini se edhe Allahu është mëkat-falës, mëshirues.”*** Tegabun 14.

Në botën që jetojmë Allahu me mëshirën dhe urtësinë e Tij të pakufishme e ka lënë që njerëzit të kenë pasuri dhe të kenë pasardhës. Njeriu gjatë jetës së tij është shumë i lidhur me këto dy gjëra të dynjasë dhe Allahu i Madhëruar i ka dhënë mundësi ta merr në dynja atë që i takon duke mos harruar botën tjetër, Ahiretin: ***“Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko*** (ta fitosh) ***botën tjetër, e mos lër mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit.”*** Kasas 77. Njeriu e ka natyrën të atillë që lakmon për pasardhës, lakmon pasuri dhe dëshiron vazhdimisht t'i shtohen si pasardhësit, ashtu edhe pasuria: ***“E ai lakmon që t'i shtoj edhe më tepër.”*** Mudethir 14, 15, dhe siç ka thënë i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam*: ***“Po të kishte i biri i Adem it dy lugina me pasuri, do të dëshironte të ketë të tretën, e nuk e ngop barkun e birit të Adem it, përpos dheu.”*** Buhariu dhe Muslimi. Një fjalë e urtë thotë: Lakmia pas dynjasë është

“...Po të kishte i biri i Adem it dy lugina me pasuri, do të dëshironte të ketë të tretën, e nuk e ngop barkun e birit të Adem it, përpos dheu...”

si të pish ujin e detit, nuk shuhet etja, por shtohet. Mirëpo Allahu i Madhëruar ua tërheq vëmendjen besimtarëve, duke iu thënë se e gjithë ajo është ***“sprovë”***. Shtimi i pasurisë e ngatërron njeriun dhe i merr pjesën më të madhe të kohës, duke e harxhuar me punët e dynjasë dhe kështu e len Ahiretin pas dore, e nuk interesohet për të. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Juve ju preokupoi përpjekja për shumimin*** (e pasurisë, të fëmijëve, të pozitës)! ***Derisa të mos i vizitoni varrezat*** (të bëheni banues të tyre - të vdisni).” Tekathur 1,2. Dhënia e tepërt pas dynjasë shkakton që njeriu të harrojë Allahun e pastaj edhe veten, siç ka thënë Allahu i Lartmadhëruar: ***“E mos u bëni si ata që e harruan Allahun, e Allahu bëri që ata ta harrojnë vetveten! Të tillët janë ata të prishurit.”*** Hashër 19. Po ashtu Allahu i Gjithëdijshtëm i këshillon besimtarët edhe me ajetin: ***“O ju që besuat, as pasuria juaj, as fëmijët tuaj të mos ju shmangin prej adhurimit të Allahut, e kush bën ashtu të tillët janë mu ata të humburit.”*** Munafikun 9. Nga ana tjetër ata që janë të kujdesshëm në këtë gjë, Allahu *subhanehu ue teala* i ka lavdëruar duke i quajtur burra: ***“Ata janë burra që nuk i pengon, as tregtia e largët, as shitblerja në vend për ta përmendur Allahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zekatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.”*** Nur 37.

Të gjitha kënaqësitë e kësaj bote sado që të jenë, janë të afatizuara. Sado që të arrijë njeriu pasuri, atë nuk mund ta marri me vete në varr, por megjithatë do ta ketë barrë në Ditën e Gjykimit. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“...e ju deri në një kohë në tokë keni vendbanim dhe dëfrim.”** Bekare 36. Edhe kjo kohë në tokë në të cilën nuk jemi përgjithmonë është një lloj mashtrimi. Allahu i Gjithëdijsëm e ka përshkruar shumë bukur këtë në këtë ajet: **“Ju njerëz dijeni se jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se lojë, kalim kohe në argëtim, stoli, krenari mes jush dhe përpjekje në shtimin e pasurisë dhe të fëmijëve, e që është si shembull i një shiu prej të cilit bima i habit bujqit, e pastaj ajo thahet dhe e sheh atë të verdhë, mandej bëhet e thyer, e llomitur, e në botën tjetër është dënimi i rëndë, por edhe falje mëkatesh dhe dhurim i kënaqësisë nga Allahu; pra jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se përjetim mashtrues.”** Hadid 20, prandaj Allahu në pjesën e dytë të ajetit të kësaj teme ka thënë: **“...ndërsa ajo që është tek Allahu, është shpërblim i madh.”** Tegabun 15. Një ditë xhumaje, kur Pejgamberi alejhi salatu ue selam po ligjëronte hytben e xhumasë, nga Shami erdhi një karvan tregtarësh dhe u dëgjua zhurma e tyre e zakonshme me të cilët i thërrisnin njerëzit për të dalë të blejnë. Një nga një u larguan dhe shkuan te tregtarët dhe mbetën një numër i vogël njerëzish duke dëgjuar hytben. Në këtë rast Allahu i Madhëruar shpalli ajetin: **“Po, kur ata shohin ndonjë tregti ose ndonjë aheng mësyhen atje, kurse ty të lënë në këmbë. Thuaju: “Ajo që është tek Allahu është shumë më e mirë se dëfrimi dhe tregtia, e Allahu është furnizuesi më i mirë.”** Xhumua 11. Shpërblimi i Allahut është shpërblimi më i madh, është shpërblimi më i mirë dhe përgjithmonë. Ai shpërblim i përhershëm është Xheneti. Allahu i Madhëruar ka thënë:

“Njerëzve u është zbukuruar dashuria ndaj të këndshmeve, ndaj grave, djemve e ndaj pasurisë së grumbulluar nga ari e argjendi, ndaj kuajve të stolisur, bagëtisë e bujqësisë. Këto janë kënaqësi të kësaj bote, po tek Allahu është e ardhmja më e mirë.” Ali Imran 14. Allahu i Lartmadhëruar ka thënë në një hadith kuds: **“Kam përgatitur për robërit e mi të mirë, salihinët, në xhenet atë që syri nuk e ka parë, atë që s’e ka dëgjuar me veshë dhe që s’ka mundur ta fantazojë me mendjen e tij.”** Buhariu dhe Muslimi. Allahu Fuqiplotë, e ka ndarë shpërblimin për besimtarët në gjëra me të cilat i ka njoftuar robërit e Vet në Librin e tij Fisnik, në Kuranin Famëlartë dhe po ashtu i Dërguari i Allahut i ka theksuar shpërblimet e Allahut në hadithet e tij, që të lakmojnë besimtarët në to, mirëpo ka edhe shumë fshehtësi, të cilat Allahu i Gjithëdijsëm i ka lënë befasi për besimtarët. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Ndërsa besimtarëve të ruajtur Xheneti u afrohet krejt afër. Kjo është ajo që u premtohej për secilin që pendohet dhe që e ruan besën e dhënë. Për secilin që i është frikësuar Zotit pa e parë dhe ka qenë i kthyer tek Ai me zemër të singertë. (U thuhet) Hyni në të të shpëtuar, se kjo është dita e përjetshme. Ata aty kanë çka të dëshirojnë, e te Ne ka edhe më shumë.”** Kaf 31-35.

Ua kisha lënë lexuesve që pjesën e fundit të këtij ajeti **“e te Ne ka edhe më shumë”** si një enigmë, apo mister që të interesohen e të bëhen kureshtarë për komentin se çfarë do të thotë **“më shumë”**, e ndoshta ajo do të na bëjë që t’i përkushtohemi më tepër urdhrave të Allahut subhanehu ue teala.

E lusim Allahun Fuqiplotë, që të na bëjë prej besimtarëve, të cilët angazhohen në jetën e tyre për të ndërtuar Ahiretin dhe të na bashkojë në dynja me vepra të mira, e në ahiret në Xhenetul-Firdeus në shoqërinë e pejgamberëve dhe robërve të mirë. Amin ■

QËLLOJA CAKUT



Nga Hakem ibën Hazën Kulefiu na përcillet, se e ka dëgjuar Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë gjatë një hutbeje të tij: “O ju njerëz nuk do të keni fuqi, apo nuk do të mundeni t’i kryeni të gjitha urdhrat e mi mirëpo mundohuni t’ia qëlloni cakut dhe përgëzohuni për këtë gjë”.

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Hadithin e shënon imam Ahmedi në Musnedin e tij, 4/212, dhe Ebu Davudi në Sunenin e tij, nr. 1096 (botimi: Bejt efkar deulije).

Në zinxhirin e tij gjendet Shihab ibën Hirashi për të cilin disa dijetarë e kanë kritikuar, si p.sh. Ibën Hibani tha: Ai gabonte aq shumë sa doli nga kufiri që të jetë i drejtë në transmetim përveç nëse pason transmetime të dijetarëve të tjerë. Por Ibën Mubareku e konsideron besnik, Ahmedi dhe Ebu Hatimi i pranojnë transmetimet e tij dhe

të njëjtin mendim ka edhe Jahja ibën Meini, edhe pse fjalët e këtyre tre të fundit nuk do të thotë aspak, se transmetimet e tij arrijnë në shkallën e haditheve të sakta. Hadithet e tij, nëse nuk kanë përcjellje dhe dëshmi nga hadithet e tjera më së shumti që mund të thuhet për to është, se janë të mira-hasen.

Këtë hadith Ibën Huzejme e konsideron të saktë. Ndërsa Albani e konsideron atë hasen –të mirë- për të cilin recensuesi i Musnedit të Ahmedit Shuajb Arnauti thotë se zinxhiri i tij është i fortë. Sido që të jetë, bazuar në shumë transmetime të teksteve të tjera nëpër librat e sakta të haditheve ky tekst hadithi

padyshim që konsiderohet në radhët e haditheve të mira, i cili kalon edhe në tekstet e sakta.

Komenti i hadithit:

Ky hadith flet mjaft qartë për kryerjen e urdhrave fetare, e sidomos e fokuson çështjen tek urdhëresat profetike të Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ai është këshillë që njerëzit të mos i marrin gjërat me hov dhe kështu të ngecin në mes të rrugës dhe në fund këshillon, që edhe pse njeriu ka mangësi e kështu mund të lodhet ai prapë duhet të mundohet që t'ia qëllojë veprave sa më në cak dhe pasi ta bëjë këtë le të përgëzohet, sepse kush mundohet dhe është i sinqertë Allahu nuk e humb atë, përkundrazi ka myzhde.

Fjala:

“O ju njerëz nuk do të keni fuqi apo nuk do të mundeni”

Kjo fjalë (nuk do të keni fuqi apo nuk do të mundeni), e cila tregon dyshim në fjali, edhe pse nuk kam hasur të ketë folur për të ndonjë dijetarë, nuk mund të them asgjë të saktë se e kujt është, fjalë nga Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, apo nga transmetuesi. Nëse është e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, atëherë themi se atë e ka përmendur më shumë si llojllojshmëri në tekst për të qenë sa më e qartë për dëgjuesit. Por nëse është fjalë e transmetuesve (e cilitdo prej tyre) themi se kjo gjë nëse aludon në diçka ajo tregon se sa të saktë ishin muslimanët e hershëm në transmetimet e fjalëve profetike, të cilët nëse dyshonin edhe në çështjen më të vogël ata e përmendnin që ta kryenin detyrimin e tyre para Allahut e pastaj edhe para njerëzve. Dyshimi në këtë fjali edhe sikur të mos ishte cekur nga transmetuesi aspak nuk do të luante peshë, sepse siç thashë në mes dy fjalëve, nuk ka edhe shumë dallime kuptimore, por më shumë është çështje e ndryshimit të shprehjeve, se sa e ndryshimit të kuptimit, megjithatë transmetuesi pasi kishte dyshime ne vetvete e ceki edhe para të

“...Ai është këshillë që njerëzit të mos i marrin gjërat me hov dhe kështu të ngecin në mes të rrugës...”

tjerëve. Me gjithë këto që përmenda aty ku anon më shumë mendja ime është fakti se një dyshim i tillë është nga transmetuesit, e kjo për dy arsye: a) sepse Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishte aq i saktë në fjalor, sa zakonisht nuk dihen raste kur për një kuptim të përmendte më shumë se një shprehje, sepse shprehjet e tij ishin në kulmin e kuptimeve më të larta, b) nëpër transmetime të haditheve kemi edhe shumë raste të tjera, ku transmetuesit ishin të dyshimtë dhe për hir të së vërtetës e përmendnin dyshimin e tyre, që t'i qëndronin sa më besnikë asaj që kishin dëgjuar apo thënë.

“O ju njerëz nuk do të keni fuqi apo nuk do të mundeni”

Kjo fjalë profetike nuk duhet të keqkuptohet duke menduar dikush se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, me të i degradon njerëzit (ua ul ambiciet), përkundrazi ne e dimë shumë mirë, se ai ishte njeriu më ambicioz për vete dhe shtytësi më i madh për të tjerët kah rruga e mirë, gjithashtu hadithet që flasin për këtë gjë arrijnë në dhjetëra sosh e ndoshta edhe në qindra. Pra këtë gjë e kemi të qartë që të gjithë. Mirëpo nëse lind pyetja pse e përmendi këtë fjalë në këtë formë, atëherë përgjigjemi me dy pika: a) ai në këtë hadith nuk ishte duke folur për ambiciet, që duhet të ketë besimtari e as për degradimin e tij nga kjo gjë, por ishte duke treguar për një realitet të pranishëm gjithmonë në histori e ai është se njeriu sado që mundohet të jetë i përpiktë prapë do t'i ikin gjëra pa i kryer në jetë dhe; b) e dinte se njerëzit janë të tillë, që

edhe do të kenë mangësi e kështu i kishte parasysh dobësitë e tyre, prandaj edhe i njoftoi për këtë realitet të padiskutueshëm, që përmes tij të kalonte pastaj tek ilaçi, të cilin edhe ua përmendi, ashtu si edhe vërehet nga pjesa tjetër e hadithit që jemi duke e komentuar.

Pra, vijmë në konkluzionin, se hadithi nuk është degradim i muslimanëve, por përkundrazi është t'i japësh kurajë atyre, ngaqë ai si i zgjedhur i Zotit ju tregonte se do të keni patjetër mangësi, por mos u demoralizoni dhe vazhdoni në shtegtimin tuaj drejt arritjes së kënaqësisë së Allahut.

Fjala: “nuk do të mundeni t'i kryeni të gjitha urdhrat e mi”

Nga kjo fjali fillimisht kuptojmë, se Profeti po fliste për urdhrat e tij, dhe në to thoshte t'i kryejmë me aq sa të kemi mundësi. Por kjo nuk nënkupton se në të nuk futen edhe urdhrat e Allahut, pra kam si qëllim ato urdhra që kanë arritur tek ne përmes Kuranit, ngase nëse shikojmë nga një kënd tjetër e dimë mjaft mirë, se çdo gjë me të cilën jemi urdhëruar në këtë fe ajo është nga Allahu pa marrë parasysh a përmendet direkt në Kuran apo nga goja e Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, sepse edhe fjalët profetike janë shpallje nga Zoti. Kështu arrijmë në konkluzionin, se në këtë fjali nuk përjashtohet asnjë urdhër, si ato kuranorë ashtu edhe ato profetike.

Ky rregull vlen për urdhrat fetare, kurse kur janë në pyetje ndalesat për to nuk bëhet fjalë, ngase njeriu duhet të largohet patjetër nga to dhe nuk ka arsye kurrë që t'i punojë ato. Si fshehtësi të kësaj çështje dijetarët përmendin faktin, se largimi nga haramet nuk kërkon aq mund sa veprimi i urdhrave, gjithashtu njeriu është krijuar pa pasur nevojë për këto haramet dhe si të tillë pra, nuk është vështirë të lihen. Le të marrim shembull alkoolin, njeriu ka lindur i panevojshëm për të dhe nuk ka vështirësi për

“...largimi nga haramet nuk kërkon aq mund sa veprimi i urdhrave, gjithashtu njeriu është krijuar pa pasur nevojë për këto haramet dhe si të tillë pra, nuk është vështirë të lihen...”

ta lënë atë, mjafton vetëm të mos e prekësh, të mos e blesh dhe të mos e vendosësh në gojë. Kurse kur janë në pyetje kryerja e urdhrave thamë se Islami e ka parasysh mundësinë e njeriut dhe ia shikon hallet e tij, kjo për arsye se gjendjet e njerëzve janë të ndryshme dhe urdhrat e Allahut janë të përgjithësuar për të gjithë njerëzit me gjendje normale, por prej tyre ka njerëz që në disa pika janë më të dobët se të tjerët dhe ndoshta nuk mund t'i kryejnë disa urdhra si duhet. Pra për këtë shkak Islami e ka parasysh këtë pikë dhe kështu kur vjen çështja tek kryerja e detyrimeve fetare çdo njeriu i shikohet gjendja dhe mundësia që ai ka. Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, me këtë fjalë të tij padyshim pati si qëllim të na tregojë, se të gjithë besimtarët nuk do të kenë mundësi të kryejnë qoftë edhe vetëm diçka nga feja. Por në fund ai tregon se edhe atëherë kur nuk mundeni ta kryeni ndonjë adhurim ju duhet që të synoni më të mirën e tij dhe të jeni sa më të saktë në të, këtë e tregon fjala e tij:

“mirëpo mundohuni t'ia qëlloni cakut dhe përgëzohuni për këtë gjë”

Fillimisht kuptohet nga fjalia, se edhe atëherë kur nuk mundeni t'i kryeni adhurimet ashtu siç ju kam urdhëruar, prapë mos i leni të gjitha ato, por aq sa të mundeni bëjeni sa më saktë dhe synojeni Sunetin

maksimalisht.

Fjala: **“T’ia qëlloni cakut”** dijetarët e komentojnë se me këtë kihet si qëllim gjuhësisht gjuajta në cak (shënjestër), kur merr diçka në shënjestër, ndërsa në këtë rast kuptohet se Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka si qëllim që t’i bëjmë sa të mundemi punët sipas Sunetit të tij, pra ta kemi gjithmonë prioritet t’i punojmë siç duhet, bile edhe atëherë kur nuk mundemi t’i kryejmë të gjitha.

Në një transmetim të Buhariut (5673) dhe Muslimit (2816) në këtë rregull profetik ceket edhe kjo shtojcë: **“Qëllojani cakut apo afrojuni atij”**, nga e cila kuptohet, se nëse nuk do t’ia qëllosh cakut tërësisht me rëndësi është ta synosh atë e së paku kur e synon edhe do t’i afrohesh. Prandaj edhe ata që nuk mund t’i bëjnë veprat tërësisht, atëherë vjen shkalla e dytë; le të mundohen t’i afrohen atyre të saktave, por me kusht, që nijeti i tij të jetë sa më i pastër dhe maksimalisht sipas Sunetit të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Me fjalën: **“afrojuni atij”** pra cakut (shënjestrës) askush nuk duhet ta keqkuptojë e të thotë se adhurimet do të pranohen nëse bëhen për afërsisht, edhe nëse nuk janë si duhet tërësisht dhe kështu të fillojë të bëjë mangësi në to dhe t’ia lehtësojë vetes adhurimet sipas epsheve të tij. Qëllimin e kësaj fjale janë dijetarët ata që e komentojnë, sepse ata janë që i kuptojnë më së miri qëllimet dhe synimet e fesë sonë. Ata përmendin, se me të është si qëllim që njeriu gjithmonë të ketë qëllimin e pastër në adhurimet e tij dhe të synojë kryerjen e punëve ashtu si duhet, duke synuar maksimumin e tyre, por pasi të mundohet t’i bëjë punët sipas këtij rregulli dhe nuk ia arrin, atëherë njerëzit e tillë arsyetohen dhe shpërblehen që së paku i janë afruar qëllimit që kishin. Kjo i ngjan njeriut që merr diçka në shënjestër dhe synon ta godasë atë në numrin dhjetë, por pasi i merr të gjitha masat

“Pa marrë parasysh i kreve apo jo të gjitha detyrimet dhe urdhrat fetare, nëse je i singertë dhe synon më të mirën sipas mësimave profetike, atëherë kurrë nuk do të jesh i humbur...”

paraprake dhe kur gjuan nëse e arrin shtatëshen e jo dhjetën, atëherë edhe për atë goditje do të shpërblehet, edhe pse ndoshta jo aq sa ta kapte maksimumin e pikëve.

Fjala: **“dhe përgëzohuni për këtë gjë”**

Në fund vjen myzhdeja për besimtarët. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk ua humbi shpresat muslimanëve, sepse Allahu është Ai që nuk e humb asnjë grimcë mundi të askujt, por kush mundohet të punojë diçka duke qenë i singertë, atëherë për të ka përgëzime. Hadithi në fund të tij kur i përmend të gjitha këto rregulla u përmbyll me përgëzimin e çdokujt që mundohet e përpiqet në këtë fe. Pa marrë parasysh i kreve apo jo të gjitha detyrimet dhe urdhrat fetare, nëse je i singertë dhe synon më të mirën sipas mësimave profetike, atëherë kurrë nuk do të jesh i humbur, përkundrazi përgëzohu dhe vazhdo në rrugën tënde, sepse Allahu do të të ndihmojë dhe në të ardhmen do ta mundësojë që punët që sot nuk po mundesh t’i kryesh, t’i kryesh ato në ditët në vijim, sepse Zoti është Ai që ndihmon, por edhe sikur të mos mundesh t’i plotësosh ashtu si duhet deri në vdekje prapë mos u mërzit, sepse ai që flet vetëm me shpallje të ka përgëzuar. Kështu përgëzohu. ■

GËNJESHTRA SI SËMUNDJE PSIKIKE

Nëse fjalët e vërteta janë të dobishme dhe të shëndetshme, të bazuara në argumente të fuqishme, atëherë edhe psika jonë është e tillë, por nëse fjalët janë gënjeshtër dhe të sëmura, e tillë do të jetë edhe psika

SHKRUAN: PRIM. MED. DR. SC. ALI F. ILIAZI

Sot të gjithë ne jemi dëshmitarë të shumë sëmundjeve psikike dhe padyshim pyesim veten, si vihet deri këtu dhe cila është mënyra e mbrojtjes nga këto gjendje psikike. Fjala apo aftësia e të folurit është një mirësi, të cilën ne e shfrytëzojmë për çdo ditë dhe është vështirë ta paramendojmë jetën tonë pa mundësinë e shprehjes. Fjala nuk është thjesht vetëm një prodhim i zgavrës së gojës dhe kordave zanore, por pasqyrë e brendisë sonë komplete. Fjala është shprehje e shpirtit dhe e mendimeve tona, d.m.th. atë që e flasim në mes të tjerave ajo flet edhe për personalitetin tonë, në atë çfarë anojmë dhe cili është vështrimi ynë në botë. Pra, meqë të folurit është shprehje e psikikës sonë, atëherë me të drejtë mund të themi se mu fjalët ndikojnë në atë se: a do të jemi person i qetë (stabil) apo i shqetësuar. D.m.th. nëse fjalët e vërteta janë të dobishme dhe të shëndetshme, të bazuara në argumente të fuqishme, atëherë edhe psika jonë është e

tillë, por nëse fjalët janë gënjeshtër dhe të sëmura, e tillë do të jetë edhe psika dhe jo vetëm fjalitë që dëgjojmë nga tjerët, por edhe fjalitë që u drejtohem të tjerëve.

Kurani Fisnik na udhëzon në çdo gjë, që na bën neve të shëndoshë dhe të lumtur, ndërsa na tërheq vërejtjen që të largohemi nga ajo që na dobëson, na sëmur e njëherësh të jemi të palumtur. Një nga gjërat për të cilat na tërhiqet vërejtja nga ana e Kuranit Fisnik është rreziku i hipokrizisë, si gjendje psikike e sëmurë e njeriut, e që mund të vërehet në ajetin vijues:

“Dhe kur atyre u thuhet: besoni, sikurse besuan njerëzit, ata thonë: “A të besojmë ashtu sikurse besuan mendjelehtët?” Në të vërtetë ata, dhe mu ata janë mendjelehtët, por nuk e dinë”.¹ Në Kuranin Fisnik është përdorur fjala mendjelehtë (pa mend) për ata që nuk dëshirojnë të pasojnë rrugën e vërtetë dhe kësaj i kundërvihen me gënjeshtër dhe mashtrime. Pra, njeriu pa mend në këtë gjendje është person larg nga kontakti me realitetin. Në bazë të këtij ajeti mund të konkludojmë, se hipokritët dhe gënjeshtarët janë quajtur të pamend,

¹ 1 Bekare, 13.



“...Scott Peck, një psikolog i njohur, i quan njerëz gënjeshtarë, sepse ata jetojnë brenda mureve të larta të frikës ndaj vetë kritikës...”

shkatërrimit total. Scott Peck, një psikolog i njohur, i quan njerëz gënjeshtarë, sepse ata jetojnë brenda mureve të larta të frikës ndaj vetë kritikës, sepse vetëkritika është thirrje në ndryshimin e personalitetit për të cilin ata nuk janë të përgatitur.

Në rast se i pranojnë vetitë, që një pjesë e personalitetit të tyre është për t'u kritikuar, atëherë vetëdija do të kërkonte që ta ndryshonin, por meqë procesi i ndryshimit të personalitetit është mjaft i gjatë dhe i dhimbshëm, atëherë shërbejnë me gënjeshtër si sedativ i pashmangshëm për kontrollimin e vetëdijes personale. Gënjeshtër u shërben atyre si tepihë nën të cilin fshehin të gjithë atë, që pamjen e jashtme të tyre do ta bënte të ndotur. Mund të thuhet që mashtruesit dhe gënjeshtarët janë të lidhur patologjikisht me status quo-në e personaliteteve të tyre dhe si të tillë me doemos u nevojitet ndihma e psikologut.

Një dijetar ka thënë: ‘bile edhe njerëzit më të këqij para se të fillojnë krimin më parë mundohen të kenë një arsytim moral për këtë akt.’ Me fjalë të tjera duhet të gënjejnë veten e tyre për të kryer krimin! P.sh. serbët para vrasjeve dhe dhunimeve gjatë luftës së kaluar e kanë bindur veten, se nëse nuk do t'i bëjnë të njëjtën gjë atyre, këtë do t'ia bënin ata këtyre dhe kështu kanë gënjyer vetëdijen e tyre për ta ruajtur paraqitjen për ata si një popull thuajse normal.

Shohim që gënjeshtër si çrregullim

atëherë për këta pa mëdyshje mund të përdoret termi psikologjik i personit mentalisht të sëmurë.

Njerëzit gënjejnë për ta ruajtur imazhin e tyre narcisoid, sepse mendojnë se janë të përkryer dhe besojnë që ndryshimi më i vogël në personalitetin e tyre i çon drejt

patologjik i psikës nuk mbetet vetëm problem i personit, i cili është sëmure, por i sjell një dëm shumë të madh shoqërisë. Shembullin e serbëve mund ta krahasojmë me shembullin e Iblisit dhe të vëresh se i kanë të përbashkëta cilësitë në sjelljet e tyre. Edhe gënjejnë për ta ruajtur imazhin e lartë për personalitetin e tyre. Ai mosbindjen e tij ndaj Allahut të Madhërishëm e shpjegoi me të metat e Ademit, si i krijuar prej dheut. Por në realitet ky shpjegim ishte një arsyetim apo paravan pas të cilit fshihej narcizizmi dhe bindja individuale, që ai ishte i përsosur dhe me këtë jashtë çdo lloj kritike. Pranimi që Ademi *alejhi salatu ue selam* është më i mirë se ai do të ishte sipas tij pranimi i mos përsosmërisë personale, dhe nga kjo bindje edhe nuk dëshiron të shmanget, për këtë ai betohet se do të vërtetojë që lloji njerëzor është i keq, për çfarë edhe përdor të gjitha mjetet, bile edhe ato që do t'i dëmtojnë njerëzit siç janë armiqësia, vrasjet, nxitja në krim, thirrja në gjërat e këqija etj.

Kështu e shohim krenarinë dhe narcizizmin, si pranga të mendjes dhe të ngritjes shpirtërore. Këta njerëz (gënjeshtarët dhe hipokritët) e kalojnë jetën në frikë pa marrë parasysh se sa paraqiten të qetë dhe të përmbajtur. Qendrat e tyre në tru nuk punojnë sipas principit të konsultimit si mundësi reale, por krijojnë një labirint të madh nga i cili nuk mund të dalin, çdo gjë u duket konfuze duke krijuar frikë dhe ndjenjën e ngulfatjes në psikën e tyre. E kjo është një gjendje e dhimbshme tek e cila kanë arritur vetë me mënyrën e të menduarit të tyre të gabuar e që nënkupton gënjeshtërën si sistem mbijetese. Allahu u tërheq vërejtjen që dhembja në tërësinë e sëmundjes emocionale është njëra prej

“...Këta njerëz (gënjeshtarët dhe hipokritët) e kalojnë jetën në frikë pa marrë parasysh se sa paraqiten të qetë dhe të përmbajtur...”

pasojave të gënjeshtreve, siç na e vërteton në Kuranin Fisnik:

“Në zemrat e tyre kanë sëmundje e Allahu ua shton sëmundjen edhe më shumë, e për shkak se ata përgënjeshtrojnë pësojnë dënim të dhembshëm”²

Në këtë shqyrtim të shkurtër për gënjeshtërën dhe pasojat e saj shohim sa është me rëndësi ajo që po themi, sepse këtë nuk do ta dëgjojë vetëm ai që ia drejtojmë fjalët tona, por edhe vetëdija jonë do t'i pranojë impulset dhe krahas me këtë do të formësojë gjendjen e vet shpirtërore dhe psikike. Prandaj nëse mendojmë që me gënjeshtërën mund t'i mashtrojmë të tjerët, atëherë mashtrohemi keq, sepse me gënjeshtërën mashtrojmë së pari vetveten e pastaj tjetrin, dhe vjedhim rastin që të ndryshohemi për të mirë, dhe të ndiejmë begatitë e jetës së vërtetë në vend të iluzioneve, të cilat i kemi paramenduar në kokën tonë. Përkujtojmë këtu duke medituuar ajetin e Kuranit Fisnik:

***“O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të Allahut dhe thoni fjalë të drejta Ai (Allahu) ju mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen juve mëkatet tuaja, e kush e respekton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh”.*³ ■**

² Bekare, 10.

³ Ahzabë, 70-71.

ELIMINIMI I DRUAJTJES (II)

Mos harroni se nuk është ndonjë defekt i trupit ai që duhet t'ju bëjë të skuqeni, por ato të shpirtit (mëkatet dhe gjynahet). Nëse një zemër është e mbushur me iman, e bukur dhe e shëndetshme, sado fatkeqe të jetë fytyra dhe ana fizike, kjo bukurë e brendshme do të lërë gjurmë të pashlyera dhe ndikim të paharruar.

SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Kur njeriu ka kurajën të bëjë diçka do t'i gjejë edhe mjetet për ta kryer atë punë. Një prej hapave të rëndësishëm drejt

eliminimit të druajtjes është t'i mbani sytë hapur dhe qepallat e palëvizshme. Përpiquni që përballë çdo individi të jeni i natyrshëm. Edukimi i të folurit do të mund të mjaftonte për ta mposhtur druajtjen. Një njeri që di të flasë nuk mund të qëndrojë

gjatë i druajtur, sepse epërsia e tij gojore do të siguronte interesim për të dhe ai duke e parë që të tjerët e dëgjojnë dhe interesohen për të do të bëhet i guximshëm.

Për të folur bukur duhet të plotësosh tri kushte: a) Të dish, të kesh me bollëk ide, kulturë të ndryshme letrare që të lehtësojë ndërtimin e fjalive dhe zgjedhjen e fjalëve. b) impostim të zërit dhe c) Qartësi në artikulum. Mësohuni vetë, lexoni me zë të lartë, drejtojuni një personi të imagjinuar. Druajtja nuk është në fund të fundit vetëm se një gjendje psikike. Sa herë që i druajturi ndjehet i turbulluar duhet të marrë frymë thellë dy a tri herë. Meqë personi në fjalë është një sajues i vetmuar, ai ka zili, urren dhe vuan duke qenë mohues. Kushti i domosdoshëm për atë që dëshiron të kalojë kundërshtarin në merita e në vlerë është të mos gënjejë vetveten, sepse të druajturit shumë shpesh gabojnë duke rënë në vetëmburrje të heshtur.

Mos harroni se nuk është ndonjë defekt i trupit ai që duhet t'ju bëjë të skuqeni, por ato të shpirtit (mëkatet dhe gjynahet). Nëse një zemër është e mbushur me iman, e bukur dhe e shëndetshme, sado fatkeqe të jetë fytyra dhe ana fizike, kjo bukuri e brendshme do të lërë gjurmë të pashlyera dhe ndikim të paharruar.

Një këshillë tjetër, mësohuni t'i shikoni të gjithë në fytyrë, më sy të qetë e të kthjellët, të ftohtë e të vendosur. Nëse skuqeni dhe dikush ua vë në dukje, përgjigjuni se nuk e çani kokën fare. Keni për ta parë se herën tjetër nuk do të skuqeni. Është shumë e udhës që të mësoheni të ballafaqoheni me ata persona dhe ato gjëra që ju bëjnë më shumë të druajtur dhe ju vënë në siklet. Përpikuni gjatë ditës të ecni sa më shumë, evitoni përdorimin e mjeteve të transportit. Evitoni njëkohësisht zemërimin, fjalosjet

“...Njeriu i patrembur ndodh që të gabojë ndonjëherë, ndërsa ai që ka frikë gabon vazhdimisht...”

dhe debatet e kota.

Në momentin e krizave të druajtjes zemra ngatërrohet, idetë lëvizin shumë shpejt, ndërsa trupi paralizohet. Njeriu i patrembur ndodh që të gabojë ndonjëherë, ndërsa ai që ka frikë gabon vazhdimisht. Njeriu nuk duhet të izohet në vetvete, duhet që të rrojë në kontakt me të tjerët, në shkëmbim të vazhdueshëm të mendimeve, e vetëm në këtë mënyrë do të arrijë realisht të njohë vetveten. Vetmia dhe izolimi është një nga shkaqet e druajtjes. Nuk duhet të jesh i druajtur nga frika se mos bën gabime, ngase gabimi më i madh është të privohesh dhe të heqësh dorë nga përvoja. Prandaj kontakti me botën është forma më e mirë për t'i shëruar të druajturit.

I druajturi ka frikë se nuk do ta përkrahin atë që ai thotë gjatë bisedës. Është i vërtetë fakti, se të gjithë ata që dëshirojnë të flasin provojnë shqetësim kur janë gati për të hapur gojën. Ekzistojnë edhe oratorë të lindur që nuk mund të flasin. I druajturi është gjithmonë një individ me fantazi dhe imagjinatë shumë të shfrenuar, ndaj duhet të përpiket që të shërohet duke e detyruar trurin të pushojë sa më shumë që të jetë e mundur. Duhet ta largojë të menduarit negativ, ndërsa për këtë kërkohet vullnet i plotë dhe vetëdisiplinë. Në mbrëmje para se të flini do të vëreni se sa shpejt një mori me ide do t'ju sulmojnë trurin. Bëhet fjalë për të gjithë episodet e ditës që do t'i

rijetoni, si mbi një ekran kinemaje. Këmbëngulni që t'i eliminoni një nga një këto ide dhe keni për të parë se çfarë pushimi dhe qetësie do të përjetojë truri dhe shpirti juaj.

Mos lini pas dore gjumin! Pa gjumë nuk mund të jeni padronët e energjisë tuaj, e truri humbet fuqinë e tij. Dy minuta relaks për trurin është i barabartë me dy orë pushim për trupin. Mos u përqendroni kurrë në mendime në mëngjes, kur sapo jeni zgjuar, sepse truri nuk është zgjuar sa duhet në atë moment. Pikë e dobët tek i druajturi është opinionin e tjetrit. Mësohuni ta thoni mendimin tuaj me qartësi dhe shkurt, të jeni padron i emocioneve tua, të keni iniciativë, qetësi, vullnet e besim në veten tuaj.

Merruni vetëm me realitetin e do të pushoni të jeni të ndjeshëm ndaj fantazive. Hyni në mbledhje ku ka shumë njerëz, mundohuni të mbani kokën drejt dhe të bëni gjeste normale dhe të vendosura. Nëse një herë jeni goditur nga kriza e belbëzimit, kur të ktheheni në shtëpi përsëritini frazat në të cilat keni ngecur para pasqyrës, derisa të arrini zotërimin e përsosur të tyre. Pasqyra është një mjet i dobishëm, sepse e detyron të okupojë shikimin, duke frenuar kështu imagjinatën. Edhe leximi me zë të lartë në pozicion të shtrirë është i këshillueshëm për të mposhtur belbëzimin. Përpikuni gjithmonë të flisni me zë të lartë, ngase të druajturit pëshpëritin.

I druajturi duhet t'ia imponojë vetes mendimin, se të tjerët janë indiferentë dhe nuk merren fare me të, duke e detyruar veten të jetë në gjendje që t'i përballojë shikimet e të tjerëve. Të druajturve u mungon sensi i realitetit dhe

“...Ekzistojnë edhe oratorë të lindur që nuk mund të flasin...”

ata nuk i shikojnë gjërat siç janë, por siç kanë frikë që të jenë, rrojnë me shqetësime, janë të shkatërruar nga emocionet dhe janë skllëvër të imagjinatës së tyre patetike. Megjithatë inteligjenca e tyre është e hollë, por ata janë viktima të ndjeshmërisë së tyre të lartë. Mos harroni se jeni një njeri e asgjë më shumë, mos e merrni veten si model i asaj që do të donit të ishit, një krijesë ideale dhe absurde që të zotërojë në vetvete të gjitha dhuntitë e mundshme fizike dhe morale. Kompozoni një model për veten sipas mundësive tuaja dhe do të shihni, se për çdo ditë do të vini duke u kompletuar. Nuk ekziston ndonjë temperament i veçantë për të druajturit, sepse ata i përkasin të gjitha temperamenteve dhe të gjitha karaktereve.

Edukimi i nënës është më i prirë për të formuar fëmijë të druajtur, ndërsa ndikimi atëror ngjall më shumë besim dhe nxit iniciativën dhe guximin. Prandaj është më mirë që fëmijët të mos jenë gjithmonë të përkëdhelur e sidomos nga nënat. Nuk duhet harruar se edhe martesat e vonuara janë shkak i druajtjes shumë më tepër sesa mendohet për fëmijët e tyre. Nga e gjithë kjo mund të nxirret përfundimi, se druajtja pothuaj nuk ekziston. Ajo ekziston vetëm pse dëshirohet të lihet të ekzistojë.¹ ■

¹ |1 Përzgjedhur nga libri “Të mposhtësh druajtjen”.

NUK E NDIEJ ËMBËLSINË E BESIMIT, Ç'MË KËSHILLONI?



ZGJODHI DHE PËRKTHEU: AGIM BEKIRI

1. Jam besimtar dhe për këtë falënderoj Allahun. Kam kryer Haxhin dhe Umren megjithatë nuk e ndiej ëmbëlsinë e besimit, ç'më këshilloni?

Përgjigje: Ne të këshillojmë, që të kujdesesh në zbatimin e urdhrave të Allahut, leximin e Kuranit, shpeshimin e dhikrit, sepse këto janë nga shkaqet më të rëndësishme për të shijuar dashurinë dhe ëmbëlsinë e besimit. Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thotë: “Tre gjëra kush i ka, do ta shijojë ëmbëlsinë e besimit: të jenë Allahu dhe i Dërguari i Tij më të dashur se çdo kush tjetër, ta dojë dikë vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë të kthehet në mosbesim pasi Allahu e ka shpëtuar, ashtu siç urren të hidhet në zjarr.” Dashuria e sinqertë ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij,

besimi në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dashuria e sinqertë ndaj vëllezërve të tu, urrejtja e mosbesimit janë shkaqet me të cilat e shijon besimin. I Dërguari po ashtu thotë: “E ka shijuar ëmbëlsinë e besimit kush kënaqet që Allahu të jetë Zoti i tij, Islami feja e tij dhe Muhamedi i Dërguari i tij.”, po ashtu ai ka thënë: “Kush do për hir të Allahut, urren për hir të Allahut, jep për hir të Allahut dhe ndalon për hir të Allahut, do ta shijojë ëmbëlsinë e imanit.” Pra, qëllimi është që të përkujtojmë sa më shpesh Allahun, të lexojmë shumë Kuranin, të përqendrohemi në fe, të duam Allahun dhe të Dërguarin e Tij, të duash vëllezërit e tu pa pasur ndonjë interes, të urresh mosbesimin dhe të gjitha mëkatet; të gjitha këto janë shkaqe për të shijuar imanin në zemrën tënde, bindju Allahut dhe të Dërguarit të Tij, kënaqësia jote është aty.

Abdulaziz ibën Baz

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com



2. Shpresoj të më ndihmoni për të gjetur atë që kam humbur, mendoj se kam humbur kënaqësinë e mëparshme, apo më mirë me thënë zemrën e mëparshme. Isha shumë e lumtur, kënaqësia ime ishte në përmendjen e Allahut, mirëpo tani nuk e ndiej një gjë të tillë, çka më këshilloni?

Përgjigje: Këtë kënaqësi të cilën po na përshkruan, apo që mundohesh ta përshkruash është një ndjenjë, të cilën Allahu i Madhëruar ua dhuron disa prej robërve të Tij për t'i parë nëpërmjet saj horizontet e larta dhe për t'i kërkuar ato, për të ripërtërirë mallin e tyre...

Nuk është e thënë që njeriu të mbetet në një shkallë të lartë të dritës dhe pastërtisë. Më parë janë ankuar edhe shokët e të Dërguarit me të njëjtën gjë, kurse mësuesi i tyre ju tha: *Sikur të vazhdoni ashtu siç ndiheni kur jeni me mua melekët do t'ju përshëndetnin për dore, në rrugë e në shtëpi, mirëpo herë-herë.*" Sheriati erdhi për t'i rregulluar të gjitha poret e jetës dhe zemrës, t'ua sigurojë një pjesë të pastërtisë dhe më pas për t'iu ndihmuar me këtë

pastërti për të tejkaluar pengesat e ndryshme në këtë botë. Kjo pastërti reflektohet në sjelljen e mirë me bashkëshortin, dhembshurinë ndaj fëmijëve, tolerancën me shokët madje edhe me armikun, indiferencën ndaj gjërave të ulëta, ambiciet për t'u larguar nga mëkatet dhe për të mos ngulur këmbë në veprimin e tyre. Sikur të mos kishe zemër nuk do ta hetoje humbjen e saj. I vdekuri nuk ndien dhimbje. Ankesa jote kthehet në disa shkaqe:

gjendja e parë e ndriçimit të imanit ka qenë e fuqishme dhe të ka ardhur vështirë dobësimi i asaj fuqie.

Probleme të ndryshme kanë ngarkuar shpirtin tënd, madje mundet që të kesh humbur ndonjë shok me të cilin ke ndarë çdo brengë, kështu që e ke ndier veten si e huaj, kërko veten te Kurani, sepse me përkujtimin e Allahut qetësohen zemrat. Lexo Kuran, dëgjo, këndo dhe medito, duke menduar gjithashtu rreth asaj se fjalët e kujt po lexon, kush i shpalli ato? Mendo se Ai të flet ty, të udhëzon, të thërret, të do edhe pse është i pavarur prej teje, kurse ti ke nevojë të madhe për të. Kërko veten tënde tek varret, aty ku pushojnë trupa të heshtur, mirëpo që flasin me gjuhën më të qartë e më të sinqertë. Shiko se si të gjithë barazohen në këtë vend! Vallë i këputi shpresat vdekja? Kërko zemrën tënde te njerëzit nevojtarë, varfanjakë, të mjerë, jetimë, të brengosur, ashtu siç duhet kërkuar zemra duke shikuar mëkatarët, të humburit që nuk marrin shembull. Kërko zemrën tënde te këshilla, a këshillohet apo gjendja e saj është ashtu siç thanë të këqijtë **“është njësoj për ne, na këshillove apo jo”** (Shuara: 136). Shpeshtoi istigfarin (kërkimin e faljes) dhe kujto se asnjëri nuk do të hyjë në xhenet me veprat e tij, përpos nëse Allahu nuk e kaplon me mëshirën e Vet.

Selman ibën Fehd el-Aude

3. Njerëzit kur pendohen zakonisht nisma e tyre në punë të mbara është e fuqishme dhe thotë: Djalli më urdhëron të punoj më pak. Kështu i shton vazhdimisht punët e mira derisa të mos dobësohet dhe t'i shuhen ambiciet dhe të mendojë, se *"Allahu nuk i ngarkon njerëzit përtej mundësive"*, pyetja ime është: *ç'më këshilloni, të startojmë fuqishëm apo gradualisht në mënyrë që të përqendrohemi?*

Përgjigje: Udhëzimi dhe pendimi tek Allahu është një prej begative më të mëdha që Allahu ia jep ndonjë muslimani. Ndryshimi i gjendjes së tij në më të mirë e afron atë më tepër me Zotin. Zakonisht ata që pendohen i kthehen fuqishëm adhurimeve dhe mundohen që ta kompensojnë atë që u ka ikur nga jeta e tyre.

Kjo është një gjë normale për sa i përket atij që pendohet sinerisht. Këtë gjë e ka përmendur i Dërguari ynë, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe gjithashtu ka përmendur atë që ndodh pas pendimit, pra shuarjen e ambicieve. Kjo është një gjë normale përpos nëse ndodh që shuarja e ambicieve të ndonjëri nuk ndalet derisa ta kthejë atë në gjendjen para se të pendohet. Për këtë arsye duhet të kemi kujdes dhe në momentet kur na shuhen pak a shumë ambiciet ne duhet të jemi mesatarë, të kapemi pas Sunetit për të ruajtur kapitalin tonë, në mënyrë që të ristartojmë fuqishëm për së dyti në kryerjen e adhurimeve vullnetare, ngase ta nisësh prej mesatares është më mirë se prej zeros.

Abdullah ibën Amri, *radijallahu anhu*, përcjell se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *"Për çdo punë ekziston një ambicie, për çdo ambicie ekziston një amulli. Ata që i kanë ambiciet e tyre sipas Sunetit tim shpëtojnë, e nëse i kap amullia në ndonjë rrugë tjetër shkatërrohen."* (Sahih Tergib).

Ebu Hurejre, *radijallahu anhu*, përcjell se i Dërguari ka thënë: *"Çdo gjë ka një ambicie,*

çdo ambicie ka një amulli, nëse ai që ka ambicie është mesatar shpresoni për të mirën, nëse tregohet për të me gisht, mos e llogaritni asgjë." (Sahih Tergib).

Robi i Zotit në mënyrë që t'u largohet dy skajeve të qortuara duhet të përpiqet të jetë mesatar. Nuk e tepron me ibadete në mënyrë që të mos goditet nga ndonjë amulli dhe t'i braktisë të gjitha, po ashtu nuk bëhet dembel dhe t'i lërë ibadetet, në mënyrë që të mos mësohet në atë mënyrë. Këto janë dy skajet e qortuara. Ai që është mesatar mbetet në rrugë të drejtë, ai që është në rrugë të drejtë arrin atje ku dëshiron Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Ebu Hurejre, *radijAllahu anhu* na përcjell, se i Dërguari ka thënë: *"Asnjërin prej jush nuk do ta shpëtojë vepra e tij.- E pyetën: -As ty, o i Dërguari i Allahut?- Tha: -As mua, nëse nuk më përshkon Allahu me mëshirën e tij. Jini mesatarë, mos e teproni, jini të arsyeshëm, mbani rrugën mesatare në mënyrë që të arrini"*.

Rezymeja: Të thërrasim për të menduar rreth haditheve të lartpërmendura, medito rreth tyre dhe dije se pendimi duhet të pasohet me falënderim. Falënderimi më i madh është të vazhdosh i penduar. Kjo nuk mund të realizohet përpos duke vazhduar me vepra të mira. Dije gjithashtu se *"punët më të dashura tek Allahu janë ato që janë të vazhdueshme edhe nëse janë pak."* Mos fillo me energji shumë të madhe, në mënyrë që mos të të godasë plogështia e menjëhershme, porse bëhu mesatar, sepse kjo është në mundësinë tënde. Sa herë që e ndien veten të zellshëm shfrytëzoje këtë në adhurime, sa herë që të kap ndonjë amulli ktheju mesatares. Lusim Allahun që t'ua lehtësojë dhe t'ju udhëzojë kah fjalët, sjelljet dhe veprat më të mira. ■

Muhamed ibën Salih Munexhid